

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetae "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 166, Gusht 2017

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

PRELË SHYTANI MËSUES, DREJTUES DHE VEPRIMTARË SHOQËROR 2 SHEMBULLOR

100-vjet arsim në Dukagjin është një histori me shumë autor, me shumë vlera, të cilët për çdo vit shkollor i kujtojmë me shumë respekt dhe mirënjohje, të gjithë ata që kontribuan në zhvillimin dhe konsolidimin e arsimit në Dukagjin, që nder më kryesoret ishte mësuesi dhe drejtuesi Prelë Shytani. Ne, nxënësit e tij e ndjejmë si obligim që ta respektojmë dhe ti japim vendin e merituar me një portret modest, në gazetën "Dukagjini", për të cilën ka një kontribut të çmuar. Prelë Shytani u lind me 26 tetor 1948, në fshatin Nënnavriq, të zonës së Shalës, në një familje me tradita patriotike dhe atdhetae, pjesëtarët e së cilës morën pjesë aktivisht në Lëvizjen Nacional-Çlirimtare, duke kontribuar fizikisht dhe materialisht, ndërsa në vitet e më vonshme kanë qenë në pararojë të progresit e të zhvillimit, duke dhënë shembullin si një familje e parë e fshatit.



Tri mrekullitë e Dukagjinit 3

- Mali, Uji e Bimësia -

Vargëmalet e Dukagjinit formojnë një kështjedhe të madhe natyrore, që ka vetëm disa hyrje si, qafa e Bishkasit, qafa e Tethores, qafa e Pejës, qafa e Ndërmajës dhe qafa e Malit të Shoshit. Kjo bukuri e rradhë me vargëmalet e Pultit, malet e Thethit, malet e Shalës si dhe malet e Shoshi, me lartësitë e tyre si, maja e Bigës, maja e Zezë, maja e Radohinës, maja e Pejës, maja e Hekurave, maja e Ndërmajës, maja e Malit të Shoshit si dhe maja e Xhanit. Në këto male ka edhe shpella karakteristike me bukuri të rralla e madhështi, ku pafundësia e tyre, si psh. shpella e Pejës në Theth, shpella e Bravnikut, shpella Gjonlekaj në Shalë dhe shpella e Çokut në Kir, të cilës nga eksploruesit e deri tanishëm nuk ju është arritur t'i gjendet fundi.

ISHTE NJË DITË KREJT E JONA

"I numërova stacionet e trenit me radhe derisa arrita këtu" më tha gjithë gaz miku im Ndue Sanaj, pas zbritjes në stacionin e takimit, Sesto Calende, në Milano - Itali. U përqaftuam, së fundi u takuam dhe ja te tre të moshuar: unë më i ri, Ndue Sanaj e Ndoc Ndoja disi në moshë, por nuk i japin vitet, sa në një pyetje, që bën disa italian se "a jeni amerikane" mu duk se e plotëson këtë mendim. Biseda filloi sikur ishte një vijim i një tregimi, histori, gjeografi, kohë e kaluar dhe së fundi realitet. Dhe ja Sesto Calende, që të kujton plotësisht Shkodrën tonë.



Muzat e Alpeve - 2017

Në kuadër të Ditëve të Diasporës, me 4 korrik 2017, filloi edicioni i V i manifestimit letrar ndërkufitar "Muzat e Alpeve - 2017". Në kuadër të këtij manifestimi çdo vit, për shkrimtarët më të mirë të treku-firit Kosovë - Mal i Zi - Shqipëri ndahet Çmimi për Vepër Jetësore "TEUTA", i cili pas Jevrem Berkoqivit, Ramiz Kelmendit, Dritëso Agollit dhe Mirash Martinoviqit, sivjet ju nda shkrimtarit dhe studiuesit të mirënjohur "Moikom Zeqo".

Kështu ka ndodhur në Ferrin e Kuq në Qafën e Barit... 9

Mbas një Amnistie tallëse në nëntor 1982, e cila nuk fali asnjë të ridënuar politik, me 2 dhjetor po të atij viti, një grup të burgosurish u transferuam nga Burgu i Ballshit – në Qafë të Barit. Ndodh në raste të veçanta, ku edhe brenda mjerimit ka një farë gëzimi. E kështu na ndodhi edhe ne ky "gëzim", duke kujtuar se po na lehtësojnë me këtë transferim "me ngritje". Po na çonin në Qafë të Barit, në një minierë bakri... Por atje "na doli gëzimi për hundësh", sa të jemi gjallë do ta kujtojmë atë Ferr mbi Ferr, atë shtypje dhe represion barbar që ushtroi komanda kriminale e kampit të burgut mbi ne.

Kontribut për datën e saktë të themelimit të bibliotekës kombëtare

Artikulli hedh dritë mbi një temë mjaft të debatueshme, atë të krijimit të Bibliotekës Kombëtare. Bazu ndër shkrime të ndryshme të gjetuna në periodikë, dokumenta, libra dhe broshura, synohet të skjarohet data e themelimit, fondi bazë mbi të cilin e kriju kjo bibliotekë, drejtuesit e saj ndër vite dhe godina ku u vendos ma së pari. Artikulli është një homazh, për Profesor Karl Gurakuqin, një nga theme-luesit e kësaj biblioteke, njeriut që të tanë jetën e vuni në shërbim të arsimit kombëtar dhe shqiptarë, në veri dhe në jug të Shqipërisë, por edhe midis arbëreshëve të Sicilisë dhe Kalabri.

100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

PRELË SHYTANI MËSUES, DREJTUES DHE VEPRIMTARË SHOQËROR SHEMBULLOR

100-vjet arsim në Dukagjin është një histori me shumë autor, me shumë vlera, të cilët për çdo vit shkollor i kujtojmë me shumë respekt dhe mirënjohje, të gjithë ata që kontribuan në zhvillimin dhe konsolidimin e arsimit në Dukagjin, që nder më kryesoret ishte mësuesi dhe drejtuesi Prelë Shytani.

Ne, nxënësit e tij e ndjejmë si obligim që ta respektojmë dhe ti japim vendin e merituar me një portret modest, në gazetën “Dukagjini”, për të cilën ka një kontribut të çmuar.

Prelë Shytani u lind me 26 tetor 1948, në fshatin Nënnavriq, të zonës së Shalës, në një familje me tradita patriotike dhe atdhetare, pjesëtarët e së çilës morën pjesë aktivisht në Lëvizjen Nacional-Çlirimtare, duke kontribuar fizikisht dhe materialisht, ndërsa në vitet e më vonshme kanë qenë në pararojë të progresit e të zhvillimit, duke dhënë shembullin si një familje e parë e fshatit.

Ai, pasi mbaroi arsimin bazë në vendlindje vijoi shkollën e mesme të përgjithshme, në Durrës, pastaj vijoi dhe përfundoi studimet e larta në Institutin e Lartë Pedagogjik, në Shkodër, dega matematike-fizike.

Përfundimi i shkollës së lartë, në vitin 1968, përkoj me masivizimin e arsimit 8 vjeçarë, edhe në Dukagjin dhe hapjen e shkollave që do të mbulonin gjithë krahinën e Dukagjinit, që ishin hapur më parë. Në këtë rast, z. Prelë Shytani pati privilegjin, që të jenë mësuesi i parë i klasës së V dhe drejtori i parë në shkollën e fshatit Gimaj të Shalës.

Për 44 vjet dhe 8 muaj në arsim, gjeografia e fshatrave që mësues Prela shërbeu si mësues dhe më shume si drejtues shkolle, ka qenë shumë e gjerë si në Plan-Gjuraj, Gimaj, Toplanë, Ura e re, Breglumi, Kushe Hot, Koplik Malësi e Madhe, si dhe 12 vitet e fundit si zv/drejtor në shkollën 9 vjeçare “Dedë Gjon Luli” Hoti i Ri, ku edhe doli në pension.

Në komunikimet, që kemi pasur me nxënës, koleg, vartës, prindër dhe drejtues të strukturave të arsimit na kanë folur fjalët më të mira, për punën dhe përkushtimin e tij të palodhur, përveç si mësimdhënës kudo me rezultate të larta në procesin mësimor-edukativ, por kishte dhe aftësi të veçanta drejtuese e komunikuese.

Karakterizohet për mënyrën e mirëkuptimit, me anën e të cilit kolektivet pedagogjike i vinte në pozita pune, kishte aftësi të rralla për të mbajtur gjallë unitetin, harmoninë në kolektivin e shkollës dhe në veçanti në trupën pedagogjike, kudo që ka punuar.

Ai ishte shumë kërkuar dhe i papajtuësishëm me të metat dhe dobësitë që vërente gjatë punës, por edhe shumë i dashur dhe i afërshëm me koleg, nxënës dhe prindër.

Tregojnë shumë mësues se, si mësues Prela paraprakisht i lajmëronte mësuesit, se do t’u shkonte për kontroll, të cilën gjë, nuk e bënin drejtuesit e atëhershëm as të sotëm, por kjo do të thotë se, mësues Prela, nuk nisej për ti zënë, por për të rritur mobilizimin dhe shkallën e përgatitjes për procesin mësimor e edukativ. Kjo metode e tij ka ndikuar në rritjen e rezultateve.

Politika e kuadrit të asnjërit sistem nuk ishte dashamirëse për zotin Prelë, se atë e kanë lëvizur shpesh nga një shkollë në tjetrën,

larg familjes, dhe shumë herë, me të vetmin motivacion; “Për të përmirësuar punën në ato shkolla!”.

Në vitin 1992 e larguan si drejtues shkolle për arsye politike edhe pse nuk ka qenë asnjëherë anëtar i PPSH, megjithatë asnjëherë nuk u dekurajua, përkundrazi ja rriten mobilizimin dhe ndërgjegjen në punë, sepse nisej nga motoja: “Çfarë faji kanë nxënësit e prindërit e tyre, pse shteti ja ka shtuar vështirësitë e punës!” Prandaj kudo ka qenë, është larguar me përshtypjet më të mira. Dhe, kjo punë e tij, ka bërë, që dhe pas shumë dekadash kanë shumë dëshirë për ta takuar dhe për të pirë kafe me të koleg, prindër dhe ish nxënës.

Ka një aftësi të rralla komunikimi e bashkëpunimi me njerëzit, por dhe një dashuri te veçantë për ta, ka fituar në çdo kohë respektin e padiskutueshëm të tyre.

Është shquar në raport me të tjerët, për zhvillimin e veprimtarive jashtëshkollore, si ato artistike dhe sportive. Shkolla ku ai drejtonte shquhej për zhvillimin e ekskursioneve me karakter edukativ e mësimor si dhe me cilësinë e veprimtarive artistike. Shkolla që ai drejtonte zinte vende nderi si në konkurse dhe festivale të ndryshme që zhvilloheshin.

Për fat, këto i kemi jetuar edhe në shkollën 8 vjeçare në fshatin Plan, e cila ishte epiqendër në zonën e Pultit.

Ai, nxënësin e konsideronte objekt dhe subjekt të mësimit duke ndërtuar marrëdhënie të drejta mësues-nxënës. Ka qenë dhe është shumë i etur për dije si dhe shumë i apasionuar pas librit, që edhe sot, për të libri është i pazëvendësueshëm, si i vetmi që të hap dritare për të parë botën. Gama e librave që lexonte e lexon ka qenë dhe është e larmishme, në veçanti libri artistike, shkencore dhe pedagogjike, të cilat kanë ndikuar në rritjen e njohurive të tij, në fushën e pedagogjisë, duke rritur gjithnjë përgatitjen shkencore në mësimdhënie. Këto njohuri, kanë ndikuar në përkrahjen e metodave bashkëkohore, duke shmangur metodat tradicionale të panevojshme. Metodat bashkëkohore kanë ndikuar në rritjen e rendimentit të orës së mësimit e arritjen e rezultateve të larta në procesin mësimor.

Përgatitjen e tij e lartë në fushën e pedagogjisë, ka ndikuar në përpjekjet e tij për t’ua transmetuar kolegeve dhe vartësve. Kjo përpjekje e tij, për ta, dhe sidomos për mësuesit e rinj, nuk ka munguar kurrë, madje as dhe sot.

Ai edhe sot rrezaton mirësi, sepse e karakterizon humori inteligjent, dinjiteti, burrëria dhe të qenurit i pranishëm në shoqëri me kontributin e tij.

Z. Prelë ka shume vlera qytetare, duke bartur vlerat më të mira nga vendlindja, që i qëndrojnë kohës dhe në veçanti duke i harmonizuar me ato të vendbanimit të ri.

Ai është një prind dhe një familjar shembullor, që bashkë me bashkëshorten e tij, Pashka Shytani kanë rritur e edukuar tre fëmijë të mrekullueshëm, Klodjanën, Arbërin dhe Ermalin, të cilët janë shkolluar me rezul-

tate të larta. Dy të paret kane formuar familjet e tyre, ndërsa i vogëli, Ermali ka emigruar në Itali, që në moshe të re, për një jetë më të mirë.

Z. Prelë është shumë aktiv si veprimtar shoqëror. Ai është ndër themeluesit e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe, sot është Kryetar i Këshillit të kësaj Shoqate. Ka marrë pjesë dhe ka dhënë një kontribut modest, në të gjitha veprimtaritë, që shoqata ka organizuar.

Ai është një ndër penat më të mira të gazetës “Dukagjini”, që në dhjetëra shkrime të tij, janë pasqyruar vlerat më të mira të trashëgimisë kulturore, resurset e Dukagjinit dhe vlerat njerëzore, veprimtaritë e shumë figurave dukagjinase të fushave të ndryshme si dhe duke ngrite problematika të ndryshme,



sidomos për arsimin e infrastrukturën. Të gjitha shkrimet janë vlerësime nga lexuesi i kësaj gazete.

Me shumë sportivitet e optimizëm, duke qenë shumë objektiv e ka marrë ndryshimin e sistemit, duke qenë pa pasion në vlerësimin e këtyre ndryshimeve me të mirat dhe jo te mirat e tyre.

Ka qenë dakord me lëvizjet demografike, sepse edhe ai vete është përfshirë në të, por ka dashur që të ishin të drejtuara dhe jo nga sytë këmbët, siç shprehet populli.

Ai është shumë kritik ndaj plagëve të reja të shoqërisë, që ndryshimi i sistemeve i solli, si gjakmarrja, droga, prostitucioni, e të tjera, që pjesë e tyre janë bërë edhe jo pak dukagjinase, se edhe ata jetojnë në këtë mjedis. Gjithnjë shpreh indinjatën se dukagjinasi po integrohen shume ngadalë në jetën urbane apo rreth saj.

Si një kontribues për dekada, në arsim është nostalgjik për arritjet që ka pasur arsimi në Dukagjin, dhe për këtë të sjell ndërmend vargun e gjatë të nxënësve të tij, të cilët kontribuojnë sot në të gjithë sektorët e jetës me shumë devotshmëri, që nga baza e deri në strukturat qendrore të administratës

shtetërore.

Prela, sot shpreh shumë pakënaqësi për arsimin në Dukagjin, për infrastrukturën e dobët e nivelin e ultë të kuadrit mësimdhënës apo nivelin e nxënësit, që është gjysmë analfabet, por optimizmi nuk i mungon.

Ka shumë vërejtje për nivelin e arsimit në përgjithësi, që sot shkolla është kthyer në eksperiment dhe shteti merret vetëm me anën formale e nuk merret fare me problematikat e përmbajtjes së rritjes cilësore të nivelit të dijeve nga nxënësit, që një pjesë e tyre po kthehen në analfabet.

Bëmë përpjekje të publikojmë veprimtarinë dhe punën e palodhur të këtij mësuesi e drejtuesi të apasionuar dhe veprimtari shoqëror i dalluar, duke qenë të bindur se meritonte më shumë, Prela, dhe shumë si ai, që janë burim frymëzimi e shembull për të gjithë mësuesit dukagjinase, për ta çuar më përpara arsimin në Dukagjin, apo kudo ku punojnë. Meqenëse edhe sot është shumë vital, kemi nevojë për këshillat dhe ndihmën e tij duke qenë të bindur se kurrë nuk do të na mungojnë.

Me këtë rast, ne kërkuam disa apinione nga ish nxënës dhe koleg të Prelë Shytanit. Ata e pritën me kënaqësi kërkesën tonë:

Inxh. Gjon Fierza, në numrin 165 të gazetës “Dukagjini” shkruan: “...Pata fatin që dëftesën e lirim, para 45 vitesh të ma i firmosë Prelë Shytani, i cili me një karrierë të gjatë si mësues e drejtues u bë një ndër personalitetet më të spikatura të arsimit në Dukagjin e jo vetëm...”

Gjon Daka, ish nxënës, sot farmacist, u shpreh: “Ruaj respektin më të madh për mësuesin tim të klasës së pestë, viti 1968. Për ecurinë time në jetën, meritë të veçantë ka mësues Prela, i cili më kultivoj dashurinë për shkollën e pasionin për të shtuar dijet, tamam si një prind i dytë...”

Rifat Isufi –Mësues në pension tha: “E ndjej veten të privilegjuar që kam punuar 3 vjet, në Shkollën 8 vjeçare, në fshatin Plan, duke pasur si drejtues z. Prelë Shytani. Respektin që gëzonte nga ne, nuk e fitoj se ishte drejtues i shkollës, drejtori i saj, por sepse e konsideronte veten të barabartë midis nesh dhe se kishte një gjuhë komunikimi shumë dashamirës, dhe se ishte i nisur gjithmonë për të na ndihmuar”.

Kole Çardaku shprehet: “Kam punuar 10-vjet me Prelën në fshatin Toplanë dhe në Hot të Ri, duke e pasur epror dhe koleg. Gjithnjë e ka karakterizuar korrektësia në punë, ku puna nuk i bënte vaji kurrë. Ishte shumë i drejtpërdrejtë dhe kishte aftësi që ti bënte për vete nxënës, prind e mësues, edhe pse ishte shumë kritik. Është fat për atë shkollë, ku shërbente një kuadër si Prela”.

I urojmë nga zemra Prelë Shytanit jetë të gjatë e të lumtur, shëndet të plotë e mendje të kthjelltë në dobi të familjes e shoqërisë duke qenë, aktiv si deri sot, dhe për një kohë sa më të gjatë.

Përgatitën Gjovalin KODRA dhe Ndue STRAGU

Tri mrekullitë e Dukagjinit

- Mali, Uji e Bimësia -

Vargëmalet e Dukagjinit formojnë një kështjedhe të madhe natyrore, që ka vetëm disa hyrje si, qafa e Bishkasit, qafa e Tethores, qafa e Pejës, qafa e Ndërmajes dhe qafa e Malit të Shoshit. Kjo bukuri e rradhë me vargëmalet e Pultit, malet e Thethit, malet e Shalës si dhe malet e Shoshi, me lartësitë e tyre si, maja e Bigës, maja e Zezë, maja e Radohinës, maja e Pejës, maja e Hekurave, maja e Ndërmajes, maja e Malit të Shoshit si dhe maja e Xhanit. Në këto male ka edhe shpella karakteristike me bukuri të rralla e madhështi, ku pafundësia e tyre, si psh. shpella e Pejës në Theth, shpella e Bravnikut, shpella Gjonlekaj në Shalë dhe shpella e Çokut në Kir, të cilës nga eksploruesit e deri tanishëm nuk ju është arritur t'i gjendet fundi.

Në malet e Dukagjinit, gjenden bjeshkë të shumta, të bukura dhe të freskëta dhe me burime uji të kulluare e të ftohtë, ku banorët e kësaj zone kalojnë 3 - 4 muaj në përrudhën e verës, kryesisht për kullotjen e bagëtive.

Bjeshkët e Shalës, si psh. bjeshka e Lotajve, maja e Lopëve, gropa e Mizës, poti I Nuseve, buni I Ndue Çunit, buni I Ndue Dedës, qafa e Pejës, Jezerca, krojnat Theth, buni I Praçes, kakini Lekaj, logu I Madh.

Bjeshkët e Shoshit si, Brashta, Balza, Lbriqje dhe bjeshkët e Palajve.

Bjeshkët e Pultit si, bjeshkët e Kirit (Plavra, Çoku e Brigjet), bjeshkët e Xhanit, bjeshkët e Gjurajve, bjeshkët e Planit si, Plani i madh, Ndërkirca, Arsat, bjeshka e Pogut si Gropcat e Kalori.

E veçanta e bjeshkëve të Dukagjinit është Thethi, si perlë e turizmit Shqiptarë, ky resurs i rradhë i jep vlerë jo vetëm Dukagjinit, por dhe gjithë Shqipërisë.

Uji si burim jete, është karakteristikë e veçantë për në Shqipëri. Burimet e shumta dhe të panumërta, duke filluar nga dy lumejtë kryesor, Lumi i Shalës që buron në Theth e përfundon në liqenin e Komanit e Lumi Kir që buron Ndërkirca të Planit e përfundon në Dri. Vlera e këtyre lumejve është pasuri e madhe për ndërtimin e hidrocentralit të Ndërlës në Shalë, për ndërtimin e mullive të blojës së drithrave të bukës, të cilët janë në çdo lagje të fshatrave të Dukagjinit.

Ky ujë pëdoret edhe për ujitjen e kulturave bujqësore. Në ujërat e këtyre lumejve gjenden dhe lloje të ndryshme peshku, por më e veçanta është lloji Trofte, për nga shija dhe është dominues mbi llojet e tjera.

Arsyet e burimeve të ujit të Dukagjinit vjen nga malet, si akumulues të bores dhe shiut, nga shpellat nëntokësore si akumulues gjatë përrudhës së dimrit, të cilat gjatë gjithë vitit bëhen vendëburime të shumta. Vetëm në fshatin Kir ka mbi 125 burime uji, nga këto, shtate janë Gurra. Mesatarisht në Dukagjin, çdo fshat ka mbi 50 burime uji, pranë të cilave në përgjithësi janë të ndërtuara shtëpitë

e banorëve duke formuar kështu dhe lagjet e fshatrave në këtë zonë.

Uji i këtyre burimeve është shumë i pastërt nga përbërja bakteriologjike dhe i freskët nga 4 – 7 grade celcius. Kjo pasuri e madhe natyrore, nuk është shfrytëzuar sa duhet si, për përpunim në fabrika për

jshmerinë e tyre. Kjo e veçantë vjen si rezultat se, në Dukagjin gjenden të gjitha zonat e zhvillimit bimësisë si, zona e Shkurreve, zona e Dushkut, zona e Ahit, zona e Pishës e zona e kullotave Alpine. Duke pasë të gjitha këto zona, në to gjenden të gjitha bimë livallore e ato medicinale që gjenden në Shqipëri.

Karakteristike për këtë zonë është dhe rritja e zhvillimi i të gjitha pemëve frutore me pëjashtim të ullirit dhe agrumeve. Nga pemë frutore vendin kryesor e zë Geshteja me vlera të mëdha ushqimore. Pas Tropojës që zë vendin e pare në Shqipëri, të dytin e zë Shkodra me gështejën e Dukagjinit e kryesisht atë të Pultit.

Përveç Gështejës, shumë mire rritet dhe zhvillohet Arra, Molla, Dardha, Qershia, Lajthia etj.

Pasuri e madhe në Dukagjin janë dhe drurët industrial si psh. Ahu, Pisha, Bredhi, Lisi dhe Panja. Me keto lëndë drusore, banorët e kësaj zone kanë ndërtuar kullat e banimit karakteristike si ato të Shales me çati alpine, me lëndë Pisha apo Pulti e Shoshi me çati me rrasa guri e lëndë Gështeje.

Duke përfundua këtë shkrim të shkurtër, lindë pyetja, Ku gjenden tri mrekulli? Vetëm në Dukagjin!

Përgatit Prel Kroj



Gurra e Çokut



Stakmite në shpellën e Çokut



Hyrja në Shpellën e Çokut



Në brendësi të Shpellës së Çokut



Shpellë në Lumin Kir



Burim uji

ujë të pishëm as për hidrocentrale. Në se kjo pasuri do të menaxhohet siç duhet, do të jetë burim të ardhurash për këtë zonë të varfër të Shqipërisë.

Bimësia në Dukagjin ashtu si dhe mali dhe uji është e veçantë në shumë llo-



ISHTE NJË DITË KREJT E JONA

“I numërova stacionet e trenit me radhe derisa arrita këtu” më tha gjithë gaz miku im Ndue Sanaj, pas zbritjes në stacionin e takimit, Sesto Calende, në Milano - Itali. U përqaftuam, së fundi u takuam dhe ja te tre të moshuar: unë më i ri, Ndue Sanaj e Ndoc Ndoja disi në moshë, por nuk i japin vitet, sa në një pyetje, që bën disa italian se “a jeni amerikane” mu duk se e plotëson këtë mendim. Biseda filloi sikur ishte një vijim i një tregimi, histori, gjeografi, kohë e kaluar dhe së fundi realitet. Dhe ja Sesto Calende, që të kujton plotësisht Shkodrën tonë. Qyteti shtrihet aty ku del lumi Ticino nga liqeni po ashtu edhe ura prej hekuri (ashtu ishte e jona dikur mbi Bunë), pastaj Lungolago, një mrekulli që dora e njeriut ka ndërtuar. Pikërisht këtu është lapidari kushtuar zbarkimit të Giuseppe Garibaldit, në qershor të vitin 1858. Duken edhe ganxhat ku u ankoruan anijet garibaldiane. Na behet se po i shohim me sy këmishkuqët që zbresin me parullën, “Italia Republike”, ku në elitën e kësaj ushtrie bënin pjese qindra ushtarë shqiptar.

“Po për kafën ku do të ndalemi?” - u thashë si me të qeshur. U ulem diku dhe me nen sy vëreja se Ndoja po shikonte majtas e djathtas dhe pastaj me tha “Shume pak njerëz këtu në bar”. Ndoshta na u kujtua Shqipëria me morine e bareve dhe të gjitha plot në çdo orë të ditës, ku mosha ma arte për punë tymoset rreth gotës së rakisë dhe kafesë me orë të tëra. “Këtu kafja pihet në këmbë dhe shpejt, ndryshe nuk ka punë” iu përgjigja duke e nuhatur mendimin e miqve të mi.

Programin e kësaj dite e kisha menduar që kur mora telefonatën e pare që Ndue Sanaj kishte arritur në Milano. Edhe pse një rrugë disi e gjatë, kaloi shumë shpejt. Ndoc Ndoja bënte bilancin e jetës dhe ndaloi pikërisht te kjo kohë, te ky realitet që vite më pare ishte një utopi, një sakrilegj, që vetëm të mendoje se një ditë do të shëtisje në Itali, dyert e burgut ishin të hapura. Vet Ndoci e kishte provuar kur ishte vetëm tete vjeç internimin, vitet e zeza të burgut Tepelenës, kishte pare ma sy vrasjet, vdekjet nga uria, privimin e lirisë “... ehuuu” - tha më në fund - “e mbi të gjitha ka një Zot që komandon”. Ndërsa Ndue Sanaj ka një jetë tjetër; kishte punuar në armen e mbrojtjes si oficer, duke arrite deri në shkallët madhore, me gradën kolonel, komandant Brigade dhe Shef Shtabi Divizioni. Rruga deri aty nuk ka qene e lehte. Ai kishte provuar transferimet që nga Kukësi e



Puka, Vau i Dejës e Tirana dhe si për të qene më afër realitetit thotë se “edhe unë i kam provuar internimet”. Dhe thoshte krejt një të vërtetë.

Arritëm së fundi. Parkeggi plot të huaj që kishin arrite para nesh mbi sponden

lindore të Lago Maggiore, poshtë së cilës me mbi 267 shkalle në zbritje, shtrihej Kompleksi Monumental kushtuar kryesisht Shenjtës Katerine, shi aty gati në një nivel me ujën.

Filluam zbritjen me këmbë (pasi kishte edhe ashensor), neper shkallët krejt guri, ku para nesh shfaqej një pamje përrallore: liqeni me varkat e mjetet lundruese, kodrat matanë me qendra banimi, gjelbërimi i përhershëm dhe mbi të gjitha energjia rinore e rikthyer në këto momente magjike, ku shkrepjet e aparateve fotografike të nxisnin me plot qejfe.

Para nesh i qetë shtrihej Lago Maggiore (Liqeni i Madh) i thirrur në kohën romake prej Plinit e Strabonit “Verbanus Lacus”



Nga e djathta në të majtë, Ndoc Selimi, Ndue Sanaj e Ndoc Ndoja, në anën Përendimore të liqenit të Madh

me një sipërfaqe prej 216 m2, me 166 km lundrim dhe që arrin deri në 372 m. thellësi. Kompleksi i futur i gjithi në shkëmb sipër e ujë poshtë përbehet prej katër seksioneve të ndryshëm siç janë kisha kapelone e Shën Nikolles, e Shën Katerines, e Maria e Re dhe Bekimit Alberto ose e “dei sassi”.

Themelimi i pare i takon rreth vitit 1170, kur barka që lundronte Alberto Besozzi u përmbys dhe ai me gjithë fuqinë e shpirtit thirri në ndihme Shën Katerinen. Ai nuk mbante mend se si u ndodh te ky shkëmb që kishte edhe një shpelle, por që vendosi të mos lëvizti nga aty për gjithë jetën duke u kthyer në një eremit. Rreth dy vite më vone, në zone plasi kolera dhe banoret filluan të strehoheshin pikërisht këtu te eremiti, por nen mbrojtjen e Shëjtnores Katerine të Aleksandrisë, e cila u shfaq disa here dhe ndodhi që të gjithë banoret jetuan për mrekulli pa asnjë sëmundje. Për këtë, po këto banore përreth vendosen të ngrënë një kishe në forme kapele pikërisht këtu, ku me 1205 vdes edhe eremiti dhe varrosët në këtë kishe. Shenjtorja Katerine ishte lindur në Aleksandria të Egjiptit dhe është martirizuar në vitin 307.

Trupi i saj u gjet më vone në malin Sinaj, i transportuar nga engjëjt dhe për këtë ndërtohet një manastir nga Justiniani në shekullin VII. Kultin e saj e përcollën në perëndim, në kohën e kryqëzatave dhe behet si shenjtorja që mbron filozofet.

Kapela kushtuar kësaj shënjtorje është një mrekulli përsa i takon pikturave dhe dy engjëjve muzikante. Në mur është shkruajtur në latinisht, që i takon shekullit të XVI: “Ex poenis suscipe coronam iucunditatis et gloria”, që do të thotë “Prej vuajtjes mori koronën e gëzimit dhe të lavdisë”.

Në këtë kompleks monumental të shenjte kanë vazhduar punime e piktura nga viti në vit e nga shekulli në shekull. Më të spikaturat afreske i takojnë shekujve XV e XVI, siç është edhe “Vallja e Vdekjes”, që ndriçojnë edhe sot me te, të njëjtën pamje e lavdi.

Pas kësaj vizite njeriu ndjehet më i lehte, por më i rende në mendime. Kështu dhe ne te tre biseduam e përshkruam vendin tone, kohet e saja të lavdishme me monumente, ndoshta më të bukura se këto, që shohim. Për këtë, sot kudo që hedh kazmën, në çdo pëllëmbë toke shqiptare do të dalin dëshmi nga dheu të një kulture e të një civilizimi që në kohet më këndejme nuk na u dha mundësia ti kemi në këmbë si gjithë bota.

Kur dielli verore po lëshonte rreze mbi Lago Maggiore dhe drejte në sytë tonë po na thërret të ndahemi në drejtime të ndryshme, me kujtesën dhe idenë se kjo ishte një dite krejt e jona.

Përgatit NDOC SELIMI, Milano, gusht 2017

TAJFUNET E GJURMUESIT TË MALSIË SË MADHE

Në prushin e kohës, herë ndriçuan, here thengjijtë na u zituan, të tjera sa një dritëzim xixëlluan, e më pas edhe një herë ndriçuan e përseri errësirë e të zituat mbetëm në mangallin e kohës. Të fshehur në gjirin e sertë të maleve, të ngrohur me rrezet e diellit të mekur ish perëndia e të parëve tanë të largët, të mësuar me shtrungën ku mjelnim delet në fillim fshatar, por, gjithmonë bijë të shqipes mbetëm. Gjithëherësh me kokën lart, me trup të hollë e të gjatë, kërkojm të gjejim gjurmët e fshehura në damarët e rreshkura të tokës, atje ku fshihen pllakëzat diamanti të qytetërimeve. Nën zgjoje të mbyllur prej helmetave shpirt gjakosurish, kërkon ky popull të dal nga humnerat e përhumbura të kohës, duke rizgjuar kujtesën e bashkëkombesave, bashkëfshatarëve, bashkëmalsorëve, të natyrës, arkeologjisë, traditave zakoneve etj. E të gjitha këto mësyen t'i realizoj me zgjuarsi, atletizëm, bashkërendim e shpërndare punën, lajmet, gjurmimet, me mjetet moderne, ky është Anton Pllumaj, me AJQ.

LABEATËT

Misioni i tij është sa atdhetar, aq edhe fisnik, i guximshëm në njohjen teorike e praktike të gjeografisë, historisë e reliveve të natyrës së trevave të Malsisë së madhe në Malit të Zi.

Në barbarizmat e armiqëve të shumtë që shkelën ne këto vendbanime më egërsinë e gjaksorit e mizorive, populli i pafajshëm u strehua në shpella. Një ndër ato asht edhe kjo shpellë në Suk të Grudës me ngjarje të dhimbshme, por, streh shpëtimi për malsorët e Grudës. Një tjetër shpell po kaq kureshtëndjellëse dhe një mrekulli e natyrës është edhe Biga e Lipovicës. Ndërsa jo larg Gurit të shtrigës në Cem të Selishtit, gjëndet një tjetër, të cilën e kërkuar studiuesit serbë gjatë viteve 1970, por malsorëve të këtyre trevave kurr nuk ua ban të ditun. Ekspedita OJQ Labeatët në kërkim të saj. Çfarë fshihet në labirintet e saj në të ardhmen eksploratori Pllumaj do të na shkruaj.

Na duhet që në shtegëtimet e djaloshit tuzian e fotografit profesionist, me grupin e tij të analizojm edhe dialektet që përdoren në malsi dhe ja për rastin në fjalë. Pra në malsi *shpellë* i thonë formacionit vertikal që në rastin e gjuhës shqipe letërare i përgjigjet *humnerës*, më tej *big* do të thotë formacioni horizontal i këtyre guvave, pra në shqipen letërare i përgjigjet fjalë *shpellë*. Një e tillë me bukuri mahnitëse është ajo e Vukal Pjetrit në Gozdec të Trieshit, Malësi e Madhe (Mali i Zi).

Lugina mjaft e thellë me shpate shumë të pjerrta gadi vertikale që shoqërojnë lumin e Cemit me shkëmbinjt dhe bimësinë e rrallë me madhësi e ngjyrimet të shumta dhe ja se si e përshkruan gjurmuesi i natyrës Anton Pllumaj: *‘‘Kanioni i Cemit të huajt e quajtnë ‘‘Bukuri tronditëse’’, ‘‘Bukuri për-rallore’’, Kanioni ma i bukur në ballkan’’, Kanjoni ma i mrrekullueshën në Europë’’*,.

Ndërsa ana tjetër e medaljes është se Shteti i Malit të Zi nuk e ka pasqyruar në hartën turistike të tij dhe as nuk bëhet fjalë për të bërë as edhe një përpjekje për investime të një rruge automobilistike. Gjithashtu investime nuk kanë kryer as shqiptarët e Malsisë së Madhe që janë milionera në SH.B. Amerikës. Gjë e cila është një vepër mjeran dhe aspak patriotik e atdhetar.

Fshatrat Fundnat shtrihen në shpatet veriprindimore të malit të Sukës të cilët

janë të rrethuara me pemë frutore dhe arat e punuara përqaq me forma e madhësi të ndryshme. Lartësia e tyre mbi nivelin e detit është nga 400 deri 700 metra. Reilevi përbëhet nga kodrina të shumëta në të cilat gjënden një numër i madh i lugjesh dhe vorbullash karstike shkëmbore. Na i përshkruan shetitësi Pllumaj.

Po në rrafshin historik si paraqitet situata? Shpejgimin na e jep mjaft saktë zbukuesi i aposionuar Pllumaj dhe ja lexojm: *‘‘Kemi praninë e rrugëve të shumëta të cilat kryqëzohen njëra me tjetrën si dhe gjënden objekte të shumta, që u përkasin periudhave të ndryshme si vorrezat nga periudha ilire, dhe mesjetare, rrënoja të kishave në periudhat të ndryshme. Ekspedita e sotme konstatoi dy rrënoja kishash të ndërtuara nga mure guri gëlqerorë pa përdorim të materialit lidhës (llaçit) Gjithashtu konstatoi edhe një fortifikim ilir, i cili për nga mënyra e ndërtimit, arkitektura, dhe materiali ndërtimorë mund t'i takojë periudhës së bronzit. Dimensionet e fortifikimit në fjalë janë 15x25 metra., (A. Pllumaj, Fb. 21.01.2017)*

Lajmet e zbuluesit, gjurmuesit, shtegëtuesit Pllumaj janë të lidhura fuqishëm me grupin e tij dhe vendasit ku ai kryen këto dhe ja një shembull, se ato janë me qindra: *‘‘Në ekspeditë muarën pjesë: Luigj Camaj, Anton Lulgjuraj, Bernard Hasanaj, Amina dhe Emin Nikaj, udhërrëfyesit e sotëm ishin Fran dhe Robert Gjolak nga Pas Shkalla. Ndërsa informacione të vlefshme muarëm nga Dedë Zef Gjolak, banor i Pas Shkallës. Po ashtu informacione të tjera muarëm nga Rrok Dodë Sinishtraj (Pas Pllat) dhe Sokol Dedë Kalaj (Kalaj),,*

Argumentet historike shkojnë përmes studimeve të thella historike, deri aty sa që të shkruhet e vërteta; me penën në letër të bardhë se përse vallë *‘‘të mbahet në heshtje dhe ky fakt i vërtetë që Shën Angelina e Serbisë është shqiptare me gjak, gjuhë dhe edukatë.,(A. Pllumaj)* Dhe ja një pjesë e shkëputur nga dokumentat historike:

‘‘Angelina Komneni-Brankoviq (1440-1520) ishte e bija e princit Gjergj Arianit Komnenit (1383-1462). Gjergj Arianit Komnen Golemi Topia kishte për grua Marinë, e cila ishte e bija e Despot Gjini Muzakës., (A. Pllumaj 15. 01.2017) I apasionuari për çështjen e shqiptarizmes, Pllumaj na mëson me këto mesazhe që të shkruajm të vërtetën e historisë shqiptare e ilire sepse ka nga ato që na janë vjedhur ose fallsifikuar nga një popull i ardhur nga pyjet e paana të rusisë veriore. Heshtja është baraz me zhdukjen, vdekjen, mohimin e vetëvetes.

Monumenti i Kryengritjes të Malsisë së Madhe më 1911 në Bratil të Deçiqit i vendosur në objektivin e diskutimeve. Duhet të mësoj gjithkush se si shoshiten e ngrihet përmendorja e së vërtetës mbi këtë ngjarje të madhe historike, duke ndjekur kujtimet e lëna nga gjyshërit, të atyre që shkelin pëllëmbë pëllëmb Malsinë e Madhe, fotografave, filmimeve, toponimeve etj. Por nuk mund të rrinë indiferent studiuesitEvarist Vatnika, Nikolas Senishtaj dhe Besnik Gjonaj të cilët nëpërmjet literaturës hedhin dritë mbi vend ngjarjen. Por nuk mbeten nën hije komentuesit e tjerë si Martin Gjocaj, Robert Ivez, Gjok Dedë Ivanaj, Luigj Camaj, Luka Juncaj, Gjergj Marash Gjokaj etj..

Ngjarje të tilla të sjelluna nga mbledhësi e botuesi i tyre në rrjetet sociale dhe

jo vetëm janë të shumta, por, neve dëshirojm ta mbyllim me këto fakte të një historie të shekullit të pesëmbëdhjetë dhe ja: *‘‘Vetëm pak kilometra nga Malësia gjindet Kështjella e Cernojeviqëve, themeluesve të Malit të Zi, aty ku mbretëroi Shtjefën Cernojeviq dhe e shoqja e tij Mara Kastrioti-Cernojeviq, e motra e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Jo larg nga ky vend gjindet edhe vorri i Shtjefën Cernojeviqit dhe Mara Kastrioti-Cernojeviq., (A. Pllumaj)*

Duke iu ramun pash më pash gjithë Malsisë së Madhe të Malit të Zi, marthonomaku ynë na ban të ditur mjaft emra gjeografik e toponimme. Dhe ja vetëm disa prej tyre. Vendbanimet (lagjet) e Kshevës shtrihen në prapashpinnën e Deçiqit. Dhe ja disa prej tyre: Pas Shkallë, Peiq, Gjonaj, Kalaj, Lamë e Bregut, Vulaj (në këtë lagje e llogarisim edhe Qafën e Blinit), Haxhaj, Pas Pllati, Lugu i Zagunit dhe Krolgoshti. Në aspektin gjeografik me Kshevën janë të lidhura edhe fshatrat fushore Rraxat e Vulajve dhe Curaj në rranxën e Deçiqit. Rranx malit Krisitor, bjeshka Koshti, Bjshkët e Këlmendit, Seiça, Maja e Kujit, Greça, Ahu i Greçës, Udha Korit-Greç, Koshtica, Maja e Sokolit, Surkuç, Bozhaj fshat, Kristori, Akulli i Ledinës, Koshtica, Rikoveci, Dimoshi, Ujvara e Dobrçinit, Shasibanim ilir pranë Ulqinit, Qafa e Dolecit, Mali Bratile, Lugu i Spisë, lugu i Dubravës, Pajniku, lugu karstik i Dubravës, qafa haksh banaj, Krevenica, Toponimet Hiqniju Trgajet, Vitojet,Krevenicës,Gjurma e Lecit, Kroji i Kshevës, Radeqi e Kroni i Traboinit. Kjo është një pasuri e madhe studimore për shkencat historike dhe etnografike.

Gjurmuesi i palodhur në krye te ekspeditave studimore e mbledhësve të folklorit etj., na sjell me plotë pasion melodinë dhe një kangë kënduar nga Lahutari JonuzDela. Nuk rreket ti jap udhë njohje rapsodit tanima mjaft popullor nëMalsi të madhe Agron Pllumaj. Ndërsa në udhëtimin e tij për të sjellë sa më shumë ngjarje të reja me prejardhje disa qindravjeçare edhe nëpërmjet gjurmimeve në fushën e historis. Dhe ja lexojm: *‘‘Veglat muzikore kanë lanun gjurmë edhe tek udhëpërshkruesi italian me emrin Xhovani Sforca, i cili në vitin 1575 udhëtoi nëpër luginën e Drinit, duke na lënë një njoftim interesant lidhur me përdorimin e tupanit (lodrës), për të kumtuar lajme nga njëri fshat në tjetrin; Ai thotë: ‘‘...dëgjohej nëpër ato male shungullima e një tupani që lajmëronte banorët se po kalonin shumë njerëz’’. (A. Pllumaj)*

Aktivisti i shqiptarizmes merr pjese në veprimtarinë e festimit të ansamblit te kësaj krahine me rastin e dhjetë vjetorit të krijimit. Rezultatet e saja janë të shkëlqyera fal mobilizimit e frymës kombëtare e bashkimit të mjaft këngëtarëve e instrumentistëve dhe ja lexojm: *‘‘Veliko Tarnovo - Bullgaria 2016’’, ku ansambli ‘‘Shqiponja,, nga Malësia e Madhe,Tuz në mesin e më se 400 ansambleve nga e gjithë bota mori vendin e parë. Por Zoti Pllumaj në odisenë e tij në kërkim të të rejave të tjera ai do të gëzohet, por, edhe krenohet kur ka zbuluar se Petër Malota regjizor i vetëm në Ollivud, ka lindur në Malsi të Madhe. Me një veprimtari të gjërë në këtë qytet të madh të kinematografisë amerikane ai nuk harron vendlindjen, duke e kujtuar edhe me filma. Por jo më pak të emocionon të derdh mbi shpirt patriotzmin e kulluar, të ban që*

të ndihesh krenar kur të prezanton artisten katër vjeçare veshur me xhubletën e vajzërisë Sofie Rukaj ku të tregon se është vajzë Këlmendi por mbesë në fshatin Koja. Po aq obelisk mburrje dhe krenarie kombëtare asht kur shtegëtari i malsisë, na jep lajmin e madh dhe mjaft prekës se Aranita Mula vajzë e Kosovës, mbesa e Malsisë së Madhe pushton Everstin me lartësi 8848m.

Ështëi palodhuri, këmbëngulsi për të zbuluar të fshehtat edhe në familjen e tij kur gjyshja i arriti të 131 vjetët, ku një gazetë e Malit të Zi e quan atë me kombësi serbe. Ndërsa zgjuarsia mpreftësie këmbëngulja për të zbuluar të vërtetën deri në fund arrin ta gjejë në rrjeshtat e të njëjtës gazetë. *‘‘Gazetarët jugosllav si gjithmon janë munduar që ujit t’a çojne në mulli të vet, por, prap se prap bien në kundërshtim me vetëveten, kur shkruajn se : ‘‘Ter-ezja (Gjurashaj) asht për kah nacionaliteti malaziane, dhe mbas disa rreshtave tjere shkruan : asht e lindun në Këlmend të Shqipërisë.,(A.Pllumaj)* Por gazetari në fjalë e nxjerr të vërtetën në dritë, kur shkruan se : *‘‘Ne nuk ishim në gjëndje për të biseduar me atë, sepse ajo nuk e dinte gjuhën serbo-kroate!.,(A. Pllumaj)*

Kontributi i këtij djaloshi me ndihmësit e tij Luigj Camaj dhe Bernard Hasanaj është një ndërmarrje me vlera të shumta, për të cilat ai duhesh të ishte ndjekur apo intervistuar për këtë punë të shkëlqyer, ku iu ndriçon mëndjen banorëve të malsisë kur i takon, interviston, fotografon apo xhiron filma mbi historinë e vendbanimeve veshjet popullore etj. Zoti Pllumaj megjithë punën e tij të palodhur, te devotshme me plotë përkushtim, nuk nguron të shkruaj edhe mirënjohjen e thellë të investuesve shqiptar me banim në SHBA për mbështetjen financiare për vitin 2017 si Kolë Ejllë Zagreda, Gjergj Zefi Dedivanaj, Kolë Nou Dedivanaj, dhe Marash Nikolla Micakaj.

Njerëz të tillë që një komentues i ka pagëzuar me një emër mjaft domethënës, *lisat e shqiptarizmes* duhen përkrahur, nxitur, propoganduar, shkruar për veprimtarinë e tyre. Përveç Marin Memës të Top Çeneel, askush nuk interesohet, apo vlerëson në një fare mënyre punën e tyre patriotike, fisnike, të guximshme, të palodhur dhe me plotë sakrefica.

Ku janë vallë Kryeministri Edi Rama me qeverinë e tij, po ato qindra gazeta revista private, televizione e radio që nuk e kanë vënë ujin në zjarr për këtë veprimtar të shquar me shoqatën OJQ Labeat?

Cili nga deputetët e shoqëroi nëpër Malsinë e Madhe, apo e takoi ‘‘bredhësin,, me mision historik e patriotik për t’u njohur ma konkretisht mbi veprën e tij dhe dy bashkëpunëtorëve?

Ndërsa misionari i shqiptarizmes çdo ditë asht në fushën e mejdanit me të gjitha bateritëe forcave, pra hovi i tij kurrë nuk ndalet, po tani ma, ndoshta do të vërshojn si lum mjetete shumta të informimit për t’iu kallzuar shqiptarëve mbarë në atdheun etnik e në emigracion se çfarë zbulimesh e propogandë me të gjitha formate mjetet kryen Anton Pllumaj, me bashkëpunëtorët e tij mbi bëmat e shqiptarëve, historinë, etnografinë dhe haroizmat në dallgët e shkumëzuara të shekujve. Të shpresojm.

Përgatite Dr. Selman Meziu,
Francë, gusht 2017

Muzat e Alpeve - 2017

NË KUADËR TE DITËVE TË DIASPORËS, ME 4 KORRIK 2017, FILLOI EDICIONI I V I MANIFESTIMIT LETRAR NDËRKUFITAR “MUZAT E ALPEVE - 2017“. NË KUADËR TË KËTIJ MANIFESTIMI ÇDO VIT, PËR SHKRIMTARËT MË TË MIRË TË TREKUFIRIT KOSOVË - MAL I ZI - SHQIPËRI NDAHET ÇMIMI PËR VEPËR JETËSORE “TEUTA”, I CILI PAS JEVREM BERKOQIVIT, RAMIZ KELMENDIT, DRITËSO AGOLLIT DHE MIRASH MARTINOVIQIT, SIVJET JU NDA SHKRIMTARIT DHE STUDIUESIT TË MIRËNJOHUR “MOIKOM ZEQU”

Në Istog ka filluar manifestimi letrar trekufitar “Muzat e Alpeve 2017”

Të rikthehet kultura e leximit të librit, kritika dhe kriteret për botime si dhe tradita e manifestimeve të mirëfillta letrare. Ndërsa shoqëria mbarë që nga familja e deri në institucionet shtetërore të marrin përsipër përgjegjësinë e tyre për krijimin e shijes për vlerën si dhe zhvillimin dhe promovimin e tyre, duke penguar kështu bashkërisht zbehjen e kulturës së leximit dhe “pushtimi” i botimeve pa kriter, ishte mesazhi që u përcoll nga manifestimi i V letrar ndërkufitar “Muzat e Alpeve - 2017”, i cili filloi, me 4 korrik 2017, në Istog.

Jeta Beqiraj, përfaqësuese e kësaj shoqate për Kosovë, foli për rrugëtimin 5 vjeçar të “TEUTËS”, i cili ndonëse i mundimshëm, për shkak të mbështetjes ndonëse të gjerë, por modeste të institucioneve tona, na bën krenar me vlerat që përfaqëson, me shtrirjen e veprimtarisë



së saj në dhjetëra komuna të trekufirit Kosovës - Shqipëri - Mal i Zi si dhe më radhitjen e shkrimtarëve me eminente të trekufirit si laureatë të Çmimit për Vepër Jetësore “TEUTA”, të cilin e ndan kjo shoqatë për çdo vit”, tha ndër të tjera Beqiraj, duke falënderuar institucionet MKRS, Med dhe komunën e Istogut.

Por, “TEUTA”, sivjet është dukshëm më e varfër nga që brenda vitit humbi dy laureatët e saj, bashkëmoshatore dhe bashkudhëtare në letra, Dritëro Agollin dhe Ramiz Kelmendin. Ndaj, shkrimtari i mirënjohur nga Kosova, Ibrahim Kadriu, i cili solli kujtime nga ndarja e Çmimit “TEUTA” për këta përfaqësues të denjë të letërsisë shqipe, këndej e matanë Drinit, të cilët u dekoruan në Bajram Currë dhe në Risan, pranë gërmadhave të selisë



ushtarake të mbretëreshës ilire, TEUTA.

Një diçka e veçante, se ketë veprimtarinë e përshëndeti edhe shkrimtari 93 vjeçar nga diaspora, Shaban Bali Nokshiqi, me banim të përhoshëm në Dallas, duke sjell emocion tek të pranishmit me vargjet e tija, të cilat vetëm për pesë vite janë botuar ne pesë libra.

Me këtë rast u promovua edhe libri i shkrimtarit të mirënjohur boshnjak, Zuvdija Hogjiq-Berisha, “Svi moji-Të gjithë të mitë”. Smajl Smaka doli për biografinë e pasur të këtij autori me origjinë nga familja shqiptare, Berisha e Kodralisë së Deçanit, si dhe për vizitën e sotme në trojet e vjetra, me ç’ rast ishin pritur edhe nga kryetari i komunës së Deçanit, Rasim Selmanaj. Sepse, të njohësh të kaluarën është obligim, tha me këtë rast përkthyesi në shqip dhe redaktori i këtij libri Dimitrov Popoviq, i cili vlerësoi se: “Zuvdija Hoxhiq Berisha, është ndër shkrimorët më të mëdhenj e më në zë në Malin e Zi, por edhe një njeri i mrekullueshëm, i cili në këtë roman biografik ka trajtuar marrëdhëniet e shkëlqyeshme të besimeve dhe entinive të ndryshme dhe si të tillë, nga ky shkrimtar i madh ata ngrihen edhe më lart dhe qëndrojnë në kohë, si bjeshkët që i mbajnë”, tha Dimitrov, për të shtuar se Zuvdiu i është bektashinj dhe bektashizmi ka një traditë shekullore dhe shembullore në Shqipëri, prej nga dolën edhe vëllezërit e shquar Avdyl, Sami dhe Naim Frashri.

Përderisa, autori i romanit Zuvdija Hoxhiq, tha në këtë rast se ardhja ime këtu është një ngjarje e veçantë. “Njeriu kur largohet nga vendlindja gjithnjë e më shpesh kujton të mirat e vendlindjes. Unë me djalin e axhës kam vizituar vendin e paraardhësve të mi në Kodrali, ku sot nuk ka më Berishë, Berishë nuk ka as në vendin tim, por ka gjithkund nëpër botë e më së tepërmi në librin tim. Halla ime ishte sëmurë keq dhe mundësia e saj për të fol në gjuhën e saj pas 50 vitesh, ka ndikuar më mirë se çdo ilaç tjetër. Ndaj, kur njeriu iu kthehet gjuhës e rrënjëve të tij, i ngjason djaloshtit të guximshëm Ante, i cili ka ftuar forcën më të madhe kur ka prej këmbëzbathur tokën e tij mëmë”, tha Hodjiq, për të shtuar se ka punuar gjatë gjithë jetës të lërë diçka që ka të

bëjë me pasardhësit e tij dhe t’ua lërë pasardhësve diçka që do ti lidh me ta.

Ndërsa, Qefserë Ibrahimaj, përfaqësuese për kulturë në komunën e Istogut tha se, Istogu gjithmonë ka dyert e hapura për bashkëpunim aty ku ekzistojnë dhe promovohen vlerat e mirëfillta kulturore. Këtë ë ka bërë me Shoqatën Rajonale të Shkrimtarëve edhe më parë dhe këtë po ë bën edhe me zbulimin dhe zhvillimin e talenteve të rinj, me punime të cilëve kemi dhjetëra botime”, tha Ibrahimaj, e cila prezantoi me dinjitet disa nga poetet e shkollës së mesme, të cilat prezantuan punimet e tyre edhe ne mbrëmjen letrare, krahas shkrimtarëve të tjerë, duke sjell një frymë të re brenda këtij manifestimi.

Pas Istogut, “Muza e Alpeve – 2017” vijoi në Shkodër

Me datën 5 korrik 2017, në Bibliotekën “Marin Barleti”, në Shkodër.

Kumtesa me teme “Letërsia shqipe dhe roli i saj historik” si dhe “Feminizmi, bota dhe kundër-bota e tij”, promovimin e librit të Radovan Zogoviqit, “Ardhësit - Këngët e Ali Binakut”, botim dje, përkthim i ri, i Anton Nikë Berishës, do të vijojë me njohjen e trashëgimisë kulturore të Shkodrës si dhe do të përmbyllet me një mbrëmje letrare.

Në Shkodër, në djepin e artit dhe të kulturës, e cila ka shumë njerëz të denjë për të qenë laureatë të ardhshëm të Çmimit Teuta. Dhe si e tillë, Shkodra e mirëpret dhe bashkëorganizon me Bibliotekën e qytetit “Marin Barleti”, e cila është epiqendra e librit në Shkodër.

Aktorja Merita Smaja, e mirënjohur në mbarë hapësirat shqiptare tha ndër të tjera se, “Për 5 vjet e shoh se “Teuta” paska vlerësuar emrat që meritojnë, sepse në art ka meritë, se nganjëherë ka tartufë, të cilët nuk e meritojnë, por

janë të zot për të dalë në krye”. tha Smaja, e cila shprehu vullnetin që karvani i Muzave të Alpeve të jetë edhe më i shtrirë në hapësirat tona etnike.

“Letërsia shqipe dhe roli i saj historik”, ishte tema mbi të cilën doli me kumtesë profesori Sali Bashota, i cili ndër të tjera tha se: “Letërsia shqipe, ndër shenjat ëmblematike e ka Shkodrën, sepse Shkodra me gjithë personalitetet e rëndësishme të kohës, të mijëvjeçarëve, është pika më e fuqishme e referencës kulturore për identitetin, qytetërimin dhe kulturën autentike të shqiptarëve”.

Ishte promovimi i librit “Ardhësit-Këngët e Ali Binakut”, përkthim dhe botim i ri i Anton Nikë Berishës, ai i cili solli në këtë takim jehonën e këtyre këngëve të mjerimit të shqiptarëve, shkruar nga një poet malazez, i cili si ardhës, bashkëpërfjetoi dhe iu dha zë vuajtjeve të shqiptarëve duke i përjetuar ato për ne dhe brezat që vinë. Ndaj, për Mirash Martinoviq në vlerësimin e tij rreth këtij libri kujtoi porosinë e Cezarecit dhënë Zogoviqit, i cili teksa po i rrëfente për vuajtjet e shqiptarëve, ai e porositi: “Shkruaj...Po s’pate letër, shkruaj në gur!”.

Ndërsa, autori i përkthimit të ri të këtij libri Anton Nikë Berisha tha se, arsyeja kryesore që e ka shtyrë të përkthejë apo ta ribotojë librin e Radovan Zogoviqit në një kohë kur njerëzit janë burgosur apo iu ka shkuar edhe koka është se: “Unë nuk kam lexuar nga asnjë autor një qëndrim dhe një qasje aq reale dhe poetikisht ngritur siç e ka bërë Zogoviqi për botën shqiptare dhe trevat e Dukagjinit”.

Të pranishëm ishin edhe përkthyesit e mirënjohur në gjuhën shqipe dhe malazeze, Qazim Muja dhe Dimitrov Popoviq.

Kjo ditë, dita e dytë e veprimtarisë u përmbyll me një vizitë trashëgimisë kulturore të Shkodrës, në kështjellën “Roza-fa”, në muzeun historik të Shkodrës dhe një mbrëmje letrare.



Muzat e Alpeve në Tuz

Edicioni i V-të i këtij manifestimi letrar, me datën 6 korrik 2017, në Tuz, dita e tretë përmbyllëse e tij për veprimtarinë letrare “Muzat e Alpeve 2017”. Kjo filloi me vizitë në Muzeun Etnografik të Malësisë, në të cilin karvanin e shkrimtarëve të trekufirit i pritë ikona e trashëgimisë kulturore, Shtjefën Ivezaj, i cili pëllëmbë pas pëllëmbë ka lëshuar shtëpinë e tij private për relikte trashëgimore, duke e shndërruar ndër muzetë më të pasur.

Xhubleta mijëvjeçare dhe flamuri kuq e zi, dy simbole të shenjta të trashëgimisë kombëtare shqiptare si dhe një publik i mrekullueshëm dhe në numër nga vendi dhe diaspora, ishin imazhi më dinjitoz me anë të të cilit karvanit të shkrimtarëve do mund t’ju ofrohej mirëseardhje në qytetin e Tuzit. Teksa ulur në karriget e rad-

poezisë dhe këngës shqipe, e cila po dëgjohet gjithnjë e më pak në këto hapësira që po shkretohen ditë pas dite. Ndërsa, i madh gëzimi dhe po aq e madhe mirënjohja nga ky hero i trashëgimisë kulturore shqiptare, i cili nuk ka një shembull të dytë në botë: “Unë jam i lumtur që kenim ardhur në muzeun e Malcisë t’u më nderoni mua dhe gjithë Malcinë dhe faleminderit për fjalët e bukura për Shtjefën Ivezaj dhe trashëgiminë tonë kulturore. Jam mirënjohës për ardhjen tuaj nga të tria shtetet dhe shpresoj të vini prapë dhe besoj se do të vini këtu edhe pas vdekjes sime. Ky takim është shumë me rëndësi sepse na bashkoi”, tha Ivezaj, duke falënderuar për kontributin rreth organizimit, Gjeto Kolën Camaj dhe Nikolle Camajn.

Përderisa poetja Shefqete Gosalci, para këngës “Thërret Prizreni mori Shkodër”, me të cilën solli një emocion të

ndërgjegjen e institucioneve që të mbrohen ato në mënyrë institucionale dhe sipas meje këta njerëz janë heronj që kanë arritur t’i ruajnë këto vlera”.

Ndërsa Moikom Zeqo, i cili i ka kush-tuar jetën studimit, shtegtimin pas gjurmëve të thesarit të trashëgimisë kulturore, promovimin e të cilit shoqata “Teuta” e ka pjesë të misionit, u shpreh se: “Shtjefeni është një shqiptar i cili tregon se atë që mund ta bëjë një individ i vetëm nuk mund ta bëjnë as një strukturë e tërë njerëzisht. Pra, është një admirim i madh por i paartikuleshëm për këtë njeri”, tha Zeqo.

Karvanit të “Muzave të Alpeve”, të përbërë nga Sali Bashota, Anton Berisha, Ajetë Beqiraj, Smajl Smaka, Shefqete Gosalci, Mirash Martinoviq, Mexhid Mehmeti e Agim Desku, si dhe nga laureati i sivjetmë i Çmimit “Teuta”, Moikom

Ndarja e Çmimit për Vepër Jetësore dhe dorëzimi i tij nga laureati i parë Jevrem Berkvoqi tek laureati më i fundit Moikom Zeqo, ishte kurora e edicionit të V-të letrar ndërkufitar, “Muzat e Alpeve 2017”, me motivacion të cilin e solli të plotë Beqiraj. “*Erudit i rrallë i historisë dhe traditës së qytetërimit shqiptar, akademiku Moikom Zeqo me veprën e tij, iu takon pararendësve të brezit të lindur pas luftës së dytë botërore, duke shprehur me një kurorë të re mendimtari dhe njeriu të shqetësuar dykuptimësinë e njeriut të sotëm, pa pasur drojë të na japë përgjigje të pafundme në se është ky realiteti i thellësive historike që ka krijuar njeriun, apo është njeriu i pa epur për ëndërrim që krijon realitetin e një bote të përbashkët dhe universale*”, thuhet ndër të tjera në arsyetimin e “Teutës”.

Moikom Zeqo, shkrimtar, piktor, studiues dhe arkeolog i shquar i hapësirave mbarëkombëtare duke marrë në dorë “Teutën” e skalitur në gurë të Trepçës, tha se: “Është ndjenjë e veçantë të marrësh çmimin “Teuta” pas recitimit të poezisë kushtuar Teutës nga doajeni i letërsisë malazeze Jevrem Berkoviq. Ky sigurisht është një homazh me karakter të madh simbolik, siç është emri i Teutës. Ne ende nuk jemi të ndërgjegjshëm pas 24 shekujsh se kush ishte në të vërtetë Teuta. Nuk jemi në gjendje ta kuptojmë, sepse, pavarësisht se është shkruar, ne ende mbetemi skllëvër të një historiani imperialist të kohës dhe ne nuk e kuptojmë dot domethënien e kësaj figure. Teuta është një heroinë e madhe semantike, jo thjesht një mbretëreshë. Ajo duke kundërshtuar, tregoi dinjitetin e një populli të madh *siç ishin Ilirët*”, tha Zeqo, i cili falënderoi shoqatën “Teuta”, për ndarjen e këtij çmimi si dhe organizatoren, Jeta Beqiraj për një eveniment kaq të dinjitetshëm.

hitura nën hijet e pemëve të shtëpisë së dikurshme e luksoze të Shtjefën Ivezajt të shndërruar në muze të katërfishtë, vapën përvëluese sikur veç për ta shuante një erë e hollë vere përzier me freskinë e

veçantë ndër të pranishmit, tha se: “Jemi të nderuar për këtë muze për këta njerëz fisnik i cili ka arritur të ruajë gjithë këto artefakte që është një kapital kulturor dhe ndoshta një ditë dot ë trokasë në

Zeqo, në Tuz iu bashkëngjitën figurat më eminente të letërsisë së Malit të Zi, si Jevrem Berkoviq, Zuvdija Hoxhiq, Fran Camaj, e të tjerë.

Edicioni i pestë i “Muzave të Alpeve”, u organizua në kuadër të “Ditëve të Diasporës” në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim dhe Kulturë të Istogut, me Bibliotekën “Marin Barleti” në Shkodër, si dhe me Muzeun Etnografik të Malcisë, në Tuz, mbështetur nga Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës, pasuar edhe nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport e Republikës së Kosovës, si dhe komuna e Istogut, ku edhe filluan veprimtaritë. Paraqitja dinjitoze e “Muzave të Alpeve - 2017” në Istog, Shkodër dhe në Tuz, i cili në masë të madhe u përcoll nga mediat e të tria shteteve, la pas vetes një rreze drite si meteor. Ndërsa, në gjirin e këtyre tri qyteteve të kulturës dhe traditës jehona e edicionit të V të manifestimit letrar trekufitar “Muzat e Alpeve - 2017” manifestimit rajonale të shkrimtarëve “do të jetojë me kohë të gjatë, përderisa karvani i këtyre shkrimtarëve do të vijojë misionin e tyre fisnik nëpër komunat e trekëndëshit kufitar: Kosovë-Mal i Zi-Shqipëri”, tha në mbyllje Jeta Beqiri.

Ky manifestim zgjoi një interesim të jashtëzakonshëm të mediave të Shqipërisë dhe të Kosovës.

**Përgatiti Ndue Sanaj
e Lulash Brigja**



Gazetës “Dukagjini”

Në përgjigje të artikullit të botuar në gazetën tuaj më 30. 06. 2017, me autor z. Ndue Sanaj, mbi librin tim me titull “Po me fortifikimin ç’patën”, dua t’iu shpreh falenderimin tim për ju si redaksi, që i bëni jehonë problemeve ushtarake, në këtë rast fortifikimit, që është ndërtuar në vendin tonë domosdoshmërisë për ta mbrojtur nga shkatërrimi.

E falenderoj z. Ndue Sanaj që në shkrimet e tij sjell fakte të rëndësishme nga përvoja e së kaluarës dhe të sotmes që e plotësojnë përmbajtjen e kësaj teme të rëndësishme.

Më jepet rasti të theksoj se ishte dëshira ime që prezanimi i librit të bëhej në Shkodër, sepse në këtë qytet të traditës dhe të kulturës së madhe, përpara 25 vjetësh mbylla karrierën time ushtarake, si dhe në respekt të kuadrove dhe efektive të ish- korpusit të 1X-të, e më pas të divizionit të Shkodrës, që mban pseudonimin e malit të Taraboshit; Në respekt të saj njësie të madhe ushtarake, që i kreu me sukses të gjitha detyrat, në atë krahë të rëndësishëm, të mbrojtjes së vëndit tonë.

Si ushtarak dhe si bashkëkohës i përgatitjes të teatrit tonë të veprimeve luftarake, në libër, kam shfaqur mendimet dhe vlerësimet e mija për fortifikimin, duke i parë nga këndvështrimi i kërkesave të luftimit dhe operacionit mbrojtës; i rëndësisë taktike dhe operative të vendosjes së objekteve në terren, sipas drejtimeve të rëndësishme të tij dhe të organizimit të sistemit të zjarrit.

Në libër jam përqëndruar tek vlerat e fortifikimit, për të rritur qëndrueshmërinë e mbrojtjes, dhe rolin që luan në mbrojtjen e forcave nga goditjet me aviacion, artileri dhe raketa, dhe të vështirësisë, që ai paraqet, për palën mësymëse.

Tri janë motivet mxitëse, që më shtynë të shkruaja për fortifikimin e mbro-

jtjes tonë të ndërtuar në atë kohë:

Së pari- është fakti që kur punoja në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, në Drejtorinë Operative, pata mundësinë të merrja pjesë në hartimin e planit të fortifikimit, që u hartua në vitin 1976. Kjo më dha mundësi të njoh vëllimin e punës dhe mënyrën e fortifikimit të drejtimeve operative të mbrojtjes; të njihem me organizimin dhe angazhimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe të ushtrisë për të realizuar brenda një pesëvjeçari, atë plan të rëndësishëm, që forconte qëndrueshmërinë e mbrojtjes sonë në atë kohë.

Së dyti- kur shkova në Shkodër, komandant i Brigadës së 1X, në vitin 1989 deri në vitin 1992, në atë njësi të madhe, me numërin koveksional 5001, gjeta të ndërtuar një brez mbrojtjeje të fortifikuar me të gjithë elementët e tij, të lidhur ngushtë me trajtëshmërinë karakteristike të terrenit që ka zona e Nënëshkodrës, nga ura e Bunës e deri në Lezhë. Fortifikimi ishte ndërtuar sipas llojeve të armëve dhe shërbimeve, sipas rendimit luftarak, dhe në funksion të këtyreve ishte bërë rajonizimi për t’u kompletuar dhe hapur forcat në një kohë sa më të shkurtër. Atë pamje fortifikuese të asaj njësie e ruaj edhe sot në kujtesën time.

Nxjtja e tretë- për të shkruar librin, ishte keqardhja që ndjej, ndaj realitetit të sotëm të gjendjes së fortifikimit, ku dora keqbërëse, spontane dhe e organizuar, kanë shkatërruar dhe po vazhdojnë të shkatërrojnë atë vepër të madhe, pa marrë parasysh vlerat ekonomike, historike, arkitekturore dhe aktuale e fortifikimit. Ndonse sot, për ne kuadrot ushtarak profesionist që jemi në rezervë e në pension, nuk flitet aspak, megjithse, ne ia njohim meritën vetes, që në vitet e para të 1960-tës, përballuam futjen në procesin e përgatitjes e të gatishmërisë

luftarake, kontigjentin e madh të trupës rezerviste, të Forcave Vullnetare dhe më vonë edhe të Rinisë Shkollore. Këto kontigjente, së bashku me trupat aktive, e rritën forcën dhe madhësinë e ushtrisë tonë. Asnjëherë më parë, Shqipëria nuk ka patur një numër aq të madh forcash dhe mjetesh nën armë, në mbrojtje të saj. Ishte detyrë e brezit tonë, që ta stërvitnim dhe ta përgatitnim atë trupë të madhe nga ana ushtarake. Detyrë që u realizua me sukses.

Ne duhet t’i njohim vetes meritën e madhe të reformimit dhe vënies mbi kritere shkencore të bazës teorike të jetës dhe veprimtarisë ushtarake, sipas primeve të Artit tonë Ushtarak. Në atë kohë, strategët tanë ushtarakë, sintetizuan në tekstin e Artit Ushtarak dhe në rregulloret e luftimit, parimet, normat dhe rregullat sipas llojeve të armëve, llojeve të luftimit dhe të operacionit.

Ishin, ata ushtarakë të lartë që me nivelin e tyre teorik dhe përvojën luftarake që kishin, që mësuan nga literatura e teoricientëve të shquar ushtarakë, Si Klauzeviçi, Makjaveli, Sun Xuja, Mahani, Frederiku i Madh, e të tjerë dhe na dhanë të formuluar 5 Ligjet objektive të luftës, siç janë: Ligji i forcës; Ligji i bashkëveprimi; Ligji i drejtimit dhe komandimit; Ligji i lidhjes dhe ndërveprimit të tre faktorëve objektiv të luftës; si dhe Ligji i shtrirjes në kohë dhe në hapësirë i veprimeve luftarake dhe i luftës në tërësi.

Ne duhet t’i njohim brezit tonë meritën për punën e madhe të projektimit, planizimit, dhe të realizimit të fortifikimit të brezave të mbrojtjes, të përgatitjes së komandave, shtabeve dhe trupave me programe gjithëvjetoje; si dhe të kryerjes me disiplinë të lartë të detyrave të gatishmërisë luftarake, sipas shkallëve dhe normave të sajë.

Ishim ne, oficerët e ushtrisë Shqiptare, që përballuam me sukses gjithë atë ngarkesë të periudhës së gjatë kërcënuese, e mbarsur me rreziqe reale, të krijuara nga fqinjët tanë dhe fuqitë ushta-

rake të kohës. Ajo fazë e gjatë përgatitore kërkonte energji, përkushtim dhe sakrificë të mëdha, sa edhe një luftë konkrete po të bëhej do të na dukej me e lehtë, se ajo do të fillonte e do të mbaronte më shpejt. Pavarsisht lodhjes dhe sakrificave që kishte, ajo periudhë pati vlerat e saj moralo-luftarake dhe ja vlejti, duke siguruar paprekshmërinë e vëndit tonë.

Për përgatitjen ushtarake gjatë periudhës përgatitore të luftës, Gjenerali dhe komandanti i shquar me origjinë shqiptare, nga arbëreshët e italisë, Gjergj Basta, që në vitet 1550 na jep një shëmbull të vyer. Ai, si ushtarak i shquar, i shquar i kohës, ka shkruar dy libra me përmbajtje ushtarako-profesionale. Librat e tij bëjnë fjalë, jo për betejat e zhvilluara nën komandën e tij, por se si shfrytëzohej periudha përgatitore e luftës, kryesisht për përgatitjen vetmore të luftëtarit, se si duhej mbajtur ushta, mburoja, si të sulmonte, si të mbrohej, si të ndiqte kundërshtarin dhe si të tërhiqej kur ishte e nevojshme; se si, kalorësi, të dinte të luftonte e të manovronte duke qënë mbi kalë, si ta drejtonte atë gjatë sulmit, mbrojtjes dhe ndjekjes së kundërshtarit gjatë betejës.

Edhe sot pas 500 vitesh mbetet aktuale përgatitja vetmore e luftëtarit nga ana taktike dhe teknike, sepse po u bë mirë kjo, do të funksionojnë mirë repartit dhe njësia në fushën e luftimit.

Për të gjitha këto tema të mëdha, ne, ushtarakët nuk mjafton vetëm të flasim kur takohemi me njëri - tjetrin, por të ulemi dhe të marrim penën, të shkruajmë dhe të argumentojmë si specialistë dhe bashkëkohës, për vlerat e mëdha të ushtrisë e të mbrojtjes sonë; sepse fjala tretet, kurse shkrimi mbetet. Këtë duhet ta bëjmë edhe për një arësye tjetër, ngaqë sot, injoranca dhe mediokriteti janë hedhur në sulm ndaj vlerave të vërteta, si në aspektet e jetës shoqërore, edhe në ato të ushtrisë dhe të mbrojtjes së vëndit.

Me respekt, Kolonel Hysen Qendro, në pension, Tiranë, korrik 2017

Marshenji - Qytezë Antike që mbart mbi vete misteret e një qyteterimi antik të varrosur prej mijëra vitesh në tokë,por i destinuar të shkatërrohet tani nga të gjallët

E cilësuar nga vëzhguesit qytezë antike dhe e pranuar me fakte nga studiuesit e institutit shkencor të arkeologjisë, Qyteza Antike e Marshenjit i jep jetë dhe ekzistencës së Malësisë së Madhe që në antikitet. Po shkruhet dhe po flitet shumë për ngjarje, fakte dhe histori të ndryshme, të cilat po lartësohen duke i kthyer ato në festa e përvjetorë sikur historia jonë e ka fillësën e saj vetëm në mesjetë, ku me keqardhje mund të them se, nëse kjo praktike do vazhdojë të zbatohet edhe në vitet e ardhshme, atëherë katastrofa e zbardhjes së rrënjëve të historisë së Malësisë së Madhe rrezikon të zhduket përgjithmonë ose të tjetërsohet, pasi në ketë mënyre po u krijohet hapësirë dhe kohë tendencave sllavomalazeze të përfitojnë nga



vërtetat historike. Fakti, që aktualisht gjendemi në prag zgjedhesh dhe vëmendja kryesore e pushtetit vendor dhe qendror është e përqëndruar tek fushata elektorale krijon një mjegullinë të favorshme për abuzues të ndryshëm, që paraqiten si arkeolog apo studiues, por, që në të vërtete janë vetëm pirate, të cilët po na vjedhin kulturën tonë. Një fenomen i tillë ka ndodhur dy vite më parë në kodërvarret e kësaj qyteze si dhe në territorin përreth saj, ku është bërë një masakër e vërtete me gërmime të shumta dhe pa asnjë kriter, deri edhe me mjete të rënda pune si kazma e lopata, madje edhe skavator, në një kohë që gërmimet arkeologjike kane një teknike pune shumë të veçante dhe të sofistikuar.

Sa ju takon këtyre fenomeneve janë vete banoret e Marshenjit, të cilët pohojnë se, për gërmime janë punësuar edhe disa fëmijë, të cilët i kane stimuluar edhe me një pagese minimale, por që në momentin e gjetjes së fondit, që mbanin këto varreza (ku nuk

ju dihet destinacioni) nuk janë lejuar të afrohen. Shumë i çuditshëm është fakti sesi këto gërmime janë bere ditën për diell dhe t’ mos ju ketë rënë në sy policisë, megjithëse kjo katastrofe është bërë pak metra larg rrugës nacionale Koplik - Zagore dhe fare pranë Burgut të ndërtuar pa kriter pranë kësaj qendre arkeologjike, e cila do duhej të ishte e mbrojtur nga shteti dhe forumi për mbrojtjen e monumenteve të kulturës.

Duke marre shkas nga këto veprime abuzive dhe mosvëmendjes së instancave përkatëse ngre zërin ti bëj thirrje pushtetit vendor, njësive administrative Kastrat dhe Shkrel, Bashkisë Malësi e Madhe, Ministrisë së Kulturës, Forumit për mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Policisë së shtetit si dhe krejt bashkësisë së Malësisë së Madhe të jene të vëmendshëm për të kryer detyrën e tyre morale, ligjore dhe qytetare për mbrojtjen e këtyre objekteve, të cilat me plot goje mund të quhen thesare të paçmuara për etnokulturën e Malësisë së Madhe dhe te kombit tone.

Përgatit nga **Rita Shkurta**

Kështu ka ndodhur në Ferrin e Kuq në Qafën e Barit...

Mbas një Amnistie tallëse në nëntor 1982, e cila nuk fali asnjë të ridënuar politik, me 2 dhjetor po të atij viti, një grup të burgosurish u transferuam nga Burgu i Ballshit – në Qafë të Barit. Ndodh në raste të veçanta, ku edhe brenda mjerimit ka një farë gëzimi. E kështu na ndodhi edhe ne ky “gëzim”, duke kujtuar se po na lehtësojnë me këtë transferim “me ngritje”.

Po na çonin në Qafë të Barit, në një minierë bakri... Por atje “na doli gëzimi për hundësh”, sa të jemi gjallë do ta kujtojmë atë Ferr mbi Ferr, atë shtypje dhe represion barbar që ushtroi komanda kriminale e kampit të burgut mbi ne.

Të burgosurit “armiqtë të rrezikshëm politik”, kishin për vete disa armiq edhe më të rrezikshëm: ambjentin natyral të ftohtë; morrat dhe pleshtat; punën tepër të rëndë me tre turne; një minierë jashtë të gjitha kushteve teknike qysh nga koha e Duçes; policinë e pa mëshirshme me të përzgjedhur nga Bulqiza dhe nga Dibra me kuadro njëri më sadist se tjetri!

Kaq dhunë personale e kolektive massive ushtruan mbi ne, kaq shumë keqtrajtme na bënë ata “kafshë”, sa është për tu çuditur se sa shumë duam!

Ja si filloi, ngritja krye ose kryengritja. Mbas një viti e gjysëm në atë kamp skllavërie, filluam të flisnim rreth një protestimi. Dikush vërejti se kjo po ndodhte çuditërisht rreth 11 vjet mbrapa, kur në maj 1973 kishte ndodhur revolta dhe kryengritia e Spaçit...

Brigada e jonë e punës, ku isha edhe unë, ishte turrn i tretë. Këtë natë coinci-

dence, maji të vitit 1984. Frontet e punës ndaheshin në grupe, nga tre vetë, minatori dhe dy punëtorë. Kur do fillonim punën pamë se mungonin shinat e vagonëve, detyrë që e kishte për të na i lënë të shtruarat turni pararendës. Ishim, minatori Ndrekë nga Fush Kruja, punëtori Ndue Pisha nga Dukagjini dhe unë nga Shkodra. Lajmëruam policin e turnit se, turni tjetër kishte harruar pa shtruar shinat dhe ky na tha:

Epo, bëni si të bëni, shtroni disa trupa deri te minerali, sa të mundni të punoni sonte, qar është.

Po shiko, shënoje këtë, në Proçes – Verbal, aman mos na dalin fjalë të tjera.

Të nesërmen në mëngjez, oficeri i rojes pyet policin:

A ka ndonjë që se ka realizuar normën?

Këta të tre, shoku oficer i rojes, nuk e realizuan normën.

Shoku oficer, ne patëm një arësye dhe e lajmëruam shokun polic të turnit. Unë për vete jam edhe i sëmurë normën nuk e arrij dot shumicën e rasteve...

Po mirë të hanë bukë njëherë dhe pastaj të dalin në punë ta plotësojnë normën.

Një nga të burgosurit merr guximin dhe flet pa leje:

Ky Ramizi, ta tha se nuk e realizon dot normën, kaq takat ka, është edhe i sëmurë. Eshhtë dënuar me disa herë në biruca për këtë punë. Por, për mbrëmë jemi dëshmitarë të gjithë, vetë polici i tha punoni sa të mundeni...

Epo, mirë le të mos dalë ky, po të tjerët po.

S’kishim fjetur as një gjysëm ore, kur na zgjon përgjegjësi i kapanonit:

Çohuni, shkoni në mensë, do ketë një mbledhje...

Po hajli, ça ka ba vaki?

Janë ngatërruar me policinë Sokol Sokoli dhe disa shokë, për çështjen që të burgosurit nuk duhet të ridalin përsëri në punë në turnin e parë se, nuk kanë realizuar normën turni i tretë.

Ashtu përgjumshëm shkojmë në mensë. Ishin mbledhur të gjithë dhe grupi rebel bashkë.

Vjen komandanti me një tufë policësh dhe na lexon një letër të shkruar, ku i quan anarkistë ata që kundërshtojnë dhe i fton të vetëdorëzohen. Sokol Sokoli replikoi disi me një lloj shamate, duke ia kujtuar se, disa policë po provokonin me qëllim një sherr të madh dhe ju rikujtoj rastësisht Spaçin e vitit 1973.

Mirë, pranojmë të vetëdorëzohemi, por mos na keqtrajtoni.

Jo për fjalë të nderit, askush nuk do të preket, fjalë burrash.

I pari, doli Kosta, një djalë i ri durrasak, djalë trim ... por menjëherë mbi shpinën e mbi kokën e tij vërsuan shkopinj të dhe ai duke mbrojtur kokën me duar po tentonte t’ju shpëtonte atyre... Turma e të burgosurve e irrituar dhe e egërsuar nga kjo pabesi, shpërtheu në britma në kor dhe në revoltë instinktivisht për të mbrojtur shokun dhe për t’u vetëmbrojtur.

Disa prej policëve, madje disa prej atyre më kriminelëve dhe disa nëpunës civilë të trembur, ia mbathën me vrap jashtë rrethimit të kampit...

Për të parën herë, mbas disa vjetësh burg, provova një ndjenjë triumfi e respekti bashkë për këtë revoltë. E meritonin ata burracakë, ata kriminelë kafshë bisha që na kishin torturuar pa pikë mëshire.

Erdhën përforcime, policë e ushtarakë, erdhi Zv/ Ministri i Brendëshëm nga Tirana dhe me ceremoni monstruoze u kryen arrestime ...

Bilanci ishte: U mbyt në hu me të rratura sadiste nga policët e kampit Sadri Sokoli. U dënuan me vdekje Sokol Sokoli dhe një djalë nga Shllaku, T. Ndoja me akuzën për terrorizëm!!! Terrorizëm pa armë, veç për fjalë e vetëmbrojtje?!

Dhe sot këto heronj, që u sakrifkuan vetëm se mbrojtën të burgosurit, nuk e di nëse i kujtoi dikush apo mbetën me atë akuzë si terroristë?!

Dhe ndodhte kështu, kur vetë sistemi e ideologjia komuniste shqiptare ishin terroriste, kur vetë shteti ishte terrorist, kur vetë udhëheqësit më të lartë të partisë dhe shtetit - ishin njëri më terrorist se tjetri, kur në parrullë shkruhej: “Në R. P. S. Shqipërisë nuk ekziston shtypja e njeriut nga njeriu” dhe kur faktikisht na shfrytëzonin më zi se, në skllavëri e bujkrobëri!

Dhe askush, nga më i larti e te i mesmi, nga Zv/ Ministri dhe deri tek ai polici shkaktari i incidentit për vdekjen e tre vetëve (që nuk po ia përmend emrin as atij, as Zv/Ministrin...) nuk kërkoi një falje, as të paktën: “Më ka çue nana sa me la gojën” ... Por, mos kujtoni se ju kemi harruar...

nga Ramiz Memçaj,
një ish i burgosur politik...

“Tajlanda” shqiptare në lumin Shalë tërheq qindra aventurierë

NATYRA E PAEKSPLORUAR, LUMI I KALTËR DHE MUNDËSITË E SHUMTA TË AVENTURAVE E KANË KTHYER SË FUNDMI GRYKËDERDHJEN E LUMIT TË SHALËS NË KOMAN NË NJË NGATËSË PIKAT E NXEHTA TË TURIZMIT NË ALPET SHQIPTARE

Grykëderdhja e lumit të Shalës në liqenin e Komanit është kthyer në dy vitet e fundit në një nga destinacionet më tërheqëse lumore të Alpeve Shqiptare. Izoluar nga majat e larta, rrjedha e vrullshme e ujit të kaltër të Shalës i ofron aventurierëve një panoramë nga ato që ngjajnë me Tajlandën e largët.

Rruga për të shkuar deri në këtë panoramë të mrekullueshme megjithatë është e gjatë dhe e larmishme. Nisja nga Tirana bëhet ende pa lindur dielli, në 5 të mëngjesit dhe ha rreth 2 orë deri në Vaun e Dejës dhe rreth 1 orë tjetër në rrugë të pashtuar për në pikën e nisjes së trageteve dhe varkave në liqenin e Komanit.

Oraret e tragetit janë 6 dhe 9 e mëngjesit. Megjithatë, për 90 euro në total (5 euro personi) varka me rreth 20 vende vihen

në dispozicion të vizitorëve për të shijuar nga afër pikat interesante të liqenit të Komanit dhe të lumit të Shalës.

Lugina e Shalës, një zonë e virgjër lumore e cila vetëm së fundmi është futur në guidat e agjencive turistike po tërheq një vëmendje të jashtëzakonshme, për shkak të natyrës së paprekur dhe mundësive të shumta që ofron.

Aventurierët mund të shijojnë eksplor-



imin e zonës me varkë, ngjitjen në majat përreth me pamje spektakolare, si dhe zhytjen në ujin e freskët të lumit të Shalës.

Megjithatë, izolimi dhe mungesa e vizitorëve deri më tani ofron ende kapacitete të kufizuara akomodimi, ndërsa fluksi i të ardhurve nga qytete të ndryshme ka nënvijëzuar shërbimin e dobët dhe ushqimin që lë për të dëshiruar.

Ata më aventurierët, arrijnë të shijojnë këtë destinacion të ri duke ngulur çadrat e kampingut për një eksperiencë plotësisht individuale rrethuar nga majat e larta, për të cilat vendasit tregojnë legjenda mesjetare.

Sipas gojëdhënave, princi Lekë Dukagjini, prijësi i dytë më i rëndësishëm i shqiptarëve pas heroit Gjergj Kastriot Skënderbeu i kaloi vitet e fundit të jetës në këtë zonë, ku gjen emërtime të tij si për shembull Guri i Lekës, një pikë strategjike që sheh luginën, nga ku mendohej që Dukagjini ruante vendin nga ardhja e turqve.

“Lumi i Shalës është një atrakcion i ri, i cili ka pak kohë që ka filluar të frekuentohet. Ai i tërheq vizitorët me ujin e kristaltë dhe natyrën e mrekullueshme,” tha për BIRN Eduard Kocli, guidë e

agjencisë Albania Alpine Adventure.

Ai shton se ky bum turistësh në dy vitet e fundit, i ka nxitur vendasit e përfshirë në industrinë e shërbimit dhe akomodimit të kërkojnë mundësi zhvillimi me nisma që do të financojnë bujqësinë e zonës, në mënyrë që vizitorët të shijojnë prodhime vendase.

Donald Balla, një i ri nga Tirana i është bashkuar një prej guidave të agjencive aventuriere për të eksploruar këtë destinacion të ri të Alpeve. Pas disa zhytjeve në ujin e akullt të lumit të Shalës, ai shprehet mjaft optimist për të ardhmen e këtij vendi.

“Për lumin e Shalës u informova në Facebook dhe vendosa ta vizitoj. U kënaqa shumë këtu dhe do t’jua rekomandoja të gjithëve. Është një natyrë e paeksploruar dhe shumë e bukur,” tha ai për BIRN.

Pas disa orëve plazh dhe një dreke të konsumuar në qetësinë e natyrës së gjelbër, vizitorët e qeshur i hipin sërish varkave të vogla për të shijuar rrugën e kthimit e cila gjarpëron nëpër liqenin e Komanit.

Përgatite Ivana Dervishi / BIRN, DITA,
August 15, 2017

Kontribut për datën e saktë të themelimit të bibliotekës kombëtare

Artikulli hedh dritë mbi një temë mjaft të debatueshme, atë të krijimit të Bibliotekës Kombëtare. Bazu ndër shkrime të ndryshme të gjetuna në periodikë, dokumenta, libra dhe broshura, synohet të skjarohet data e themelimit, fondi bazë mbi të cilin e kriju kjo bibliotekë, drejtuesit e saj ndër vite dhe godina ku u vendos ma së pari.

Artikulli është një homazh, për Profesor Karl Gurakuqin, një nga themeluesit e kësaj biblioteke, njeriut që të tanë jetën e vuni në shërbim të arsimit kombëtar dhe gjuhësisë shqiptare, në veri dhe në jug të Shqipërisë, por edhe midis arbëreshëve të Siçilisë dhe Kalabrisë.

Deri më 2010, data e themelimit të Bibliotekës Kombëtare ishte 10 dhjetori i vitit 1922. Në mujin korrik të 2010-s, zotni Aurel Plasari, ish-drejtori i Bibliotekës Kombëtare, shtypi dhe opinionin vendas njoftuen se data e themelimit të bibliotekës, bazu në konsultimet e shtypit, por edhe të dokumentave të tjera ishte saktësisht, 10 korrik 1920, pra, në muejt e parë të vendosjes së Qeverisë shqiptare në Tiranë e saposhpallun krëqytet. Në këtë

ipërisë”, botim i Shoqatës së Punonjësve të Bibliotekave, data e themelimit shënjohej 10 dhjetor 1922, (në variantin anglisht shënjohej 10 dhjetor 1920). I të njëjtit mendim janë edhe P. Tako e E. Domi, që në zânin Biblioteka Kombëtare në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar” caktojnë përsëri si datë themelimi, 10 dhjetor 1922.

Në fletët e “Hyllit të Dritës”, Bardhyli (alias Llukë Karafili), nismëtari i parë i studimit të bibliotekave shqiptare prej lashtësisë deri në vitin 1944, tuj na dhënë njoftime për bibliotekat e Tiranës, sa i takon “Bibliotekës Kombëtare” shkrunte: “Në vizitën time që i bëra Drejtorit të kësaj biblioteke dhe Z. Tij (autori nuk jep emnin-shënim im) pati mirësinë e na shpjegoi gjithë sa e pyetëm. Biblioteka Kombëtare u themelue në vitin 1921-1922 prej Ministris së Arsimit Kombtarë”

Ma tej, në botimin “Shqipnija më 1937: Veprimi shtetnor gjatë njëzet e pesë vjeteve të parë të vetqeverimitë”. Vol.I. shkruhet: “Ideja e themelimit të një biblioteke në Tiranë ka qenë për herë të parë në vjetin 1922. Me përkujdesjen e

krijimit të bibliotekës e muzeut kombëtar. Tuj marrë shkas nga njoftimi i mësipërm ai hedh poshtë këtë datë tuj hedh dritë rreth dy datave, që lidhen me krijimin e saj, atë të krijimit të bërthamës së bibliotekës viti 1920, dhe datën e saktë inaguruese, 28 nanduer 1922.

Qe çka shkrunte ai: “Më 11 mars 1920 ushtria franceze me në krye gjeneralin Bardi de Fortou e la Shkodrën, qi e pat mbajtë nën sundim, qysh prej vjetit 1918, atëherë kúr Austriakët patën qënë terhjekë nga qyteti. Po atë ditë mbasdreket krejt populli i Shkodrës, me të madh e me të vogël i primë nga Sulça Beg Bushati dhe Shuk Sarreqi, i doli para tek Ura e Bahçallekut, nën rrënonjat e Kishës së Zojës së Këshillit të Mirë, Ahmet Zogut, i cili, si ministër i Punëve të Mbrendëshme, n’emnin e Qeverisë së Tiranës mori në dorëzim për t’a bashkue me trupin e Atdheut. I nënshkruemi i asaj kohe vepronte si mis e sekretar i Komisis Letrare, e cila kishte pasë vù themelet, nën drejtimin e Luigj Gurakuqit, njëj Bibljoteke albanologjike tue mbledhë veprat më ne shëj t’albanologjisë. Në një

katër kthinash të vogla sá me t’u marrë fryma, me dritore si biruca që lëshojshin dritë sá mos me thye qafen, me pak orendí edhë këto të vjetrueme; në këto oda punojshin katër-pesë nënpunës; një sekretar, një protokolist, një arkivist, një shërbtuer... e një ministër.

Në njënen nga këto oda u vendosen raftat me librat e sjellun nga Shkodra; këta qenë nisërza (fillimi) e asaj qi mã vonë e muer emnin “Bibljoteke Kombtare”, që do t’i hapte dyert e saj me 28 nanduer 1922”. Prej citimit të masipërm po veçoj dy grimca konstatimesh: “nisërza” (fillimi) që asht viti 1920, (datë që përkon me 95-vjetorin e sotëm të bibliotekës), dhe datën e inaguruese 28 nandorin i vitit 1922.

Grimcën e parë po e trajtoj ma poshtë tuj vijue me përcjellë kujtimet e Gurakuqit: “Mbas Sotir Pecit u zgjodh ministër i arsimit Rexhep Mitrovica, njeri i vullneshëm, përparimdashës, me pamje të largta dhe nisjatur punësh të dobishme. Në kohën e tij ministria e arsimit u shpërngul nga shtëpia e Selim Stermasit e padenjë për një ministri në shtëpin e Abdi Toptanit,



logjikë në vitin 2015 u festu 95- vjetori i themelimit të B. Kombëtare. Natyrisht, tuj respektu drejtuesit e fundit të B.K, si dhe bashkëpunëtorët e tyne shpresoj që 20 dhjetori i vitit 1920, ka me kenë mã së fundmi data fikse e krijimit të këtij institucioni. E nënvizoj këtë fakt mbasi deri më tash, festimet e përvjetorëve të krijimit të bibliotekës janë shoqënu gjithnji ndër vite me polemika.

Shkaku i polemikave është ditun, ka ardhë pikërisht prej datës së themelimit, e së bashku me atë edhe burimi i fondeve që e kanë kriju, emnat e drejtuesve të saj ndër vite, godina ku është vendosë etj.

Studiues të bibliotekave shqiptare, por edhe në botime, që për kah rëndësia munden me u cilësue dokumenta, japin data të ndryshme të themelimit të bibliotekës.

Po paraqes mã poshtë disa burime publicistike, në të cilat data e krijimit të Bibliotekës Kombëtare sillet rrokull viteve ‘20, të shekullit që sapo kaloi, pra 1920, 1921-1922, 1922 e 1923.

Në broshurën “Bibliotekat e Shq-

Ministrisë së Arsimit, e cila ka pasë formue një bibliotekë qysh në kohë të drejt. Përgjith. Të Arsimit me 1917-19 në Shkodër, në vjetin 1922 asht bamë edhe një grumbullim librash shumica dhurata, të cilat formuen bazën e Bibliotekës Kombëtare të ardhshme.

Polemikat rreth datës së krijimit të Bibliotekës Kombëtare u rigjallnuen edhe një herë mbas kremtimeve të bame me rasë të 40- vjetorit të themelimit të kësaj biblioteke, në Tiranë, më 24 shkurt 1963.

Gazeta “Drita” e asaj kohe njoftonte mbi mbledhjen kushtu 40- vjetorit të krijimit të Bibliotekës Kombëtare, organizu me 18 shkurt 1963, me pjesëmarrjen e Zv/kryetarit të parë të Këshillit të Ministrave dhe ministër i Arsimit dhe Kulturës shokut Manush Myftiu dhe sekretares së Komitetit të Partisë për qytetin, (e Tiranës- shën. im) shoqes Fiqiret Shehu. Nisun nga ky njoftim del një datë e re e themelimit të bibliotekës, viti 1923.

Ky njoftim nuk kaloi pa reagime. Kësaj radhe reagoi në fletët e revistës “Shenjza”, Karl Gurakuqi, njeni nga nismëtarët e

pjekje qi pat me Zogun, u poq mendimi për t’a shpërngulë në Tiranë, bibljoteken e Komisis. Nuk vonoi shumë dhe ministri i atëherëshëm, Sotir Peci me shkresë zyrtare, përcjellë me dy gisht letër private, i lutej të nënshkruemist të gjente mënyrën për të sjellë në krëqytet të gjitha orendit dhe arkivin e ish-drejtorisë së përgjithshme t’arsimit, e cila kish pasë veprue në Shkodër gjatë pushtimit austriak nën kryesin e Luigj Gurakuqit, ashtu edhe bibljotekën e Komisis Letrare. Aso kohe mjetet e transportit ishin të pakta e të pamjaftueshme; udhëtimi i njerzvet për në Tiranë bëhej me karrocë e zgjaste tri ditë të mira. Nuk mbetej tjetër rrugë veç ajo e dedit, por edhe kjo me shumë pengime. Zûna me qirâ një barkë të madhe me vela Ulqinakësh, e, nëpër Bunë e gjatë bregut të Adriatikut mbas tri ditësh e mbas tri netësh, mërrijta në Durrës. Prefekti i qytetit Rexhep Jella, u kujdesue për dërgimin e plaçkavet në Tiranë, në ministrinë e arsimit, e cila i kishte zyrtat e veta në një nga shtëpijat e Selim Stermasit në Rugën e Postës. Ishte kjo një shtëpi

nit, në Rugën Pjetër Bogdanit, e cila ma vonë pat qenë ble nga Viansone, qi e shëndrroi në bujtinë me emnin “Continental”. Shtëpia ishte e gjanë, me shumë oda, me një kopësht të madh përpara. Në pjesën përdhese ishte një salon i madh nga ana e rrugës; këtu u vendosën librat e Bibljotekës së arsimit, e cila kishte ardhë tue u pasunue me botime të ndryshme të bleme apo të dhurueme; kujdesin e saj e pat i nënshkruemi, deri sa kjo me 28 nanduer u përrurue e muer emnin: “Bibljoteke Kombetare”.

Për grimcën e dytë, pra për përrurimin, K. Gurakuqi shkruente: “Në ket përrurim morën pjesë të gjitha auktoritetet e vendit tue fillue te ministrat, prefekti, kryetari i bashkisë, dhe një shumicë e madhe populli. Fjalimin e rasës, e mbajtiti ministri i arsimit Rexhep Mitrovica e fill mbas tij foli shkruesi i këtyne radhëve tue theksue randsinë e bibljotekave për kulturën e Komit”.

Pa dashtë me i hý polemikave, mendoj se “nisërza” (fillimi) ishte Biblioteka e arsimit drejtimin e të

Intoleranca mes nesh

Gjithmonë na lavdërojnë ne shqiptarët si popull tolerant sidomos në konceptin religjionar dhe padyshim me shembujt e shumtë dhe atë etnik - racor! Është e vërtetë se jemi të tillë si me religjionet dhe me etninë, sepse asnjëherë nuk ka shembuj të ashpër as evidentë të intolerancës në këto dy drejtime. Shqiptari nuk persekuton as për fe, as për racë dhe as për kombësi! Nuk ka në historinë e tij shembuj që ta turpërojnë në këto drejtime! Në të vërtetë, ata që deklarojnë (shpesh herë të huaj) se jemi tolerantë në religjion ja fusin kot! Plotësisht kot fare dhe pa ditur në thelb faktorin kryesor që atyre ju duket se mund të përcaktohet si "tolerancë"?! Janë pak studiues dhe njohës të mirë të historisë dhe padyshim fakteve të saj që e kuptojnë se nuk ka kuptim termi "tolerancë" për religjionin në Shqipëri! Na ngatërrojnë me popuj të qytetëruar, të cilët tashmë janë bërë mbas shumë gafash, fajesh dhe gabimesh, por dhe mbas shumë lufrash - tolerantë! Me shqiptarët, kjo gjë nuk është fare e vërtetë! Sot, në fakt është një ditë e jashtëzakonshme e botës së krishterë, por dhe e botës tjetër që nuk ka në bazament krishterimin si religjion! Ky moment është pjesë e festimit për shqiptarët dhe shfaqje e madhe ceremonish festive - e padyshim gëzimi. Predikimi kryesor është

paqja dhe lumturia mes njerëzve pa dalim religjioni, kombësie dhe etnie! Por po kthehem pikërisht në këtë ditë - të arsyetoj pse e kanë gabim për shqiptarët, kur thonë se janë tolerantë në besim! Gabojnë me "tolerantë", sepse ne nuk tolerojmë njëri -tjetrin - por bashkëjetojmë?! Shqiptarët edhe në kohë të vështira pushtimi, apo dhe ngatërrese të madhe botërore, nuk ishin tolerantë, por të bashkuar në religjionet e tyre përballë si pushtimit, si armikut si dhe sulmit përçarës nga do të vinte. Shqiptarët nuk tolerohen kur martohen me njëri - tjetrin, por bashkëjetojnë dhe religjioni nuk ju bën kurrfarë ndarje, të cilat që nga 11 shtatori po trondit botën?! Janë shumica musliman, por në botën e qytetëruar ato nuk kanë kurrfarë dallimi përveç faktit që shoqëria e tyre, duhet akoma të përparojë në drejtime arsimimi dhe politike në demokraci?! Shqiptarët nuk tolerohen, por bashkëjetojnë në religjion, sepse e dinë mirë dhe qartë, drejtimin e duhur dhe pse ka shumë ndërhyrje kohët e fundit për ta prishur këtë bashkëjetesë?! Shqiptarët mbase ekzagjerohen kur flasin me nerv, por nuk duan tja dinë se çfarë race je, apo çfarë besimi ke?! E kjo nuk është tolerancë - por botëkuptim ndryshe në modernen qytetare që bota ka shekuj që e ka me libra dhe me mësim.

Shqiptari e ka instikt dhe provë të jetës së tij në shekuj?! Për këtë duhet të jemi krenarë. Ne kemi një të keqe të madhe në anën tjetër! Ne nuk jemi tolerantë me veten?! Nuk tolerojmë shpesh herë njëri - tjetrin?! Na bën keq nervi jonë shqiptaro - ballkanik! E për më tepër, kur na ndërhyt politika që e kemi faktor aspak modern dhe qytetëruar! E gjithë ajo mrekulli religjionare dhe qytetërimi në bashkëjetesë, na prishet kur filon problemi në pushtet. Ky është dhe momenti më i dobët në atë intolerancë të madhe mes nesh! Egërsia e fjalëve të disa liderëve politikë, raporti fjalë poshtërues në politikë me shoqërinë si ndikim, kërkimi i pushtetit me një pathos idiot dhe dëmpurës - na bën intolerantët më të fortë dhe më të pashpjegueshëm, pothuaj në rajon?! Me veten tonë e kam fjalën?! Ky është problemi i madh i joni, sepse shpesh herë për politikë dhe pushtet, shfaqim intolerancën më të madhe, mes qënies tonë shoqërore si shqiptarë?! Në fakt është turpi ynë, por dhe retroja jonë më e madhe shoqërore. Na ka bërë dëme të mëdha, ka shkaktuar viktima politike dhe shkatërime të shtetit dhe shoqërisë. Ka derdhur gjak kjo intolerancë e madhe dhe këto nerva të mëdha pushteti në mënyrë brutale të shprehura ndër kohëra të zymta!

Ky është problemi më i madh që kemi dhe normalisht fyen si ndërgjegjen kombëtare dhe atë qytetare, që me sa duket ende nuk është formuar përsëmbart. Pastaj kur grindemi për pushtet në saj të politikës - intoleranca shfaqet në çdo qelizë si të ishte vërtetë jetesë mes nesh?! Kurse e vërteta është se na imponohet nga sipër. Nga disa kokrra që fatëkeqësisht ende shoqëria jonë i mban për "burra të mirë" dhe që shfrytëzojnë këtë gjëmë marrëzie për pushtet, që na tërheq zvarrë! Burra dhe gra të tilla të fjalëve të rënda dhe që nxisin intolerancën i dëgjojmë të gjithë në TV dhe Radio apo i lexojnë për ditë, dhe ky është ushqimi më i keq që i jepet shoqërisë shqiptare.

Grindjen e madhe pushtetërore e duan një dorë kopukësh që kanë çerek shekulli që sundojnë pikërisht për këtë ves të tyrin, që duket sikur e kanë cilësi të fortë?! Në të vërtetë janë kriminelë në kurriz të shoqërisë dhe duan të mbajnë kështu, intolerante me veten pikërisht për të sunduar politikisht mbi të?! Ky sot është momenti për të bërë atë ndarje nga këto njerëz dhe nga intoleranca në dukje e jona, por me veten?! Ndarja nga ky moment përbën dhe ndarjen nga tranzicioni i gjatë i joni. Ky moment sa ka filluar dhe me sa duket do të vazhdojë duke bërë intolerancën e fundit që është ajo me "drejtësinë e pa drejtë" në këtë vend?! Mbase ky është moment dhe po të jetë kështu - mirë se të vijë?!

Përgatiti , Besi BEKTESHI

◀ cilës e pati Karl Gurakuqi. Nëse historia e Bibliotekës Kombëtare fillon në vitin 1920, atëhere padyshim duhet bā edhe një ridimensionin e figurave, që e drejtuan këtë bibliotekë.

Karl Gurakuqi siç u lexua, nuk e emnon vedin drejtor të bibliotekës kombëtare, por drejtues i përkohshëm i Bibljotekës së Arsimit, e cila falë kontributeteve të tija personale dhe eksperiencës së fitueme gjatë viteve 1917-1919, do të shëndrruhej në "Bibljotekë Kombëtare". Nëse si datë themelimi merret dhjetori i 1920-s, atëhere i takon Karl Gurakuqit me kenë Drejtori i parë i kësaj biblioteke, e jo drejtor i parë i përkohshëm, siç e cilësonte vedin.

Por përsëri mbesim në qerthullin "nisërzave" (fillimeve) dhe përrurimit. Asht 1922-shi, viti që daton jo vetëm themelimin e Bibliotekës e të Muzeut Kombëtar, por zgjidh edhe problemin e Drejtorit të parë, të këtyne institucioneve që ishte Viskë Babatasi. Kjo pohohet nga K. Gurakuqi, por edhe nga dokumentet e kohës.

Viskë Babatasi, me një detyrë të dyfishtë, drejtor i bibliotekës dhe i muzeut pati kenë një personë e diskutueshme në drejtimin e institucioneve. Në vitet që pasun, pra nga viti 1928 kur u thirr nga Zogu për me drejtue bibliotekën filologu beratas Sotir Kolea e deri në vitin 1937, biblioteka dhe muzeu u vendosën në baza të vërteta shkencore të kohës, aq sa sipas shkrimeve biblioteka arriti për të parën herë me botue të përvjetshmet e punëve të saj.

Biblioteka e Komissisë në dritën e dokumentave.

Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës

(1916-1918) krahas trajtesave filologjike, një kujdes të veçantë i kushtoi edhe problemeve kulturore, mes të cilave vlen për t'u theksu organizmi i bibliotekës, nismë e Kryekomandës austriake të pushtimit.

Në regjistrin e protokollit të Komissisë Letrare Shqipe, datë e themelimit të kësaj biblioteke është 16 prilli i vjetit 1917.

Në protokollin e kësaj dite shënohet: "Morën pjesë në këtë mbledhje: z. Gurakuqi, Mjedja, Logoreci, Mosi, Naraçi. Me 16 të prillit u themelue biblioteka e Komissisë letrare d.m.th biblioteka e Shqipnis.

Kryekomanda i kishte çuem Komissinë një letër me Nr. 1106, me 28.3.1917, qi foli përmbi trajtimin e bibliotekës së Komissisë. U vendue: I ngarkohet Z. Mosi me marrë listën e libravet, qi kanë "shtypshkronjat" "Nika" dhe "Zoja e Papërlyeme".

I pāmë me vëmendje, dokumenti nxjerr në pah disa gjāna, që për momentin mendoj se nuk janë trajtu si duhet. Mā së pari, nëse pohojmë se B. Kombëtare u krijui tūj u bazū në fondet e bibliotekës së Komissisë, atēherë duhet shēnjū edhe rolin e Austrisë në themelimin e kēsaj krijese.

Krahas personave, që morën pjesë në themelim të tërthjekë vēmendjen edhe terminologjia e përdorun në këtë rasë: "Biblioteka e Shqipnis".

Tuj pā shumicēn e pjesēmarrësve mendja na thotē se kjo terminologji mund të këtë karakter lokalist, kjo e lidhun edhe me zonat e pushtimit austriak, por tūj ju bashku mendimit të S. Pecit (publicist, pedagog, dhe autor tekstesh, nga Korça) për këtë çështje, atēhere mundena me pretendue se Biblioteka e Komissisë ka kenë e para bibliotekë publike

shqiptare, që në terminologjinë e kohës pëlqehet me u emnuë në ngjasim të bibliotekave austriake: "Bibljoteka popullore shqipe të lirë".

Biblioteka qysh nga themelimi u bë shpesh objekt i diskutimeve dhe vendimeve të rëndësishme të Komissisë për mbarrëvajtjen e pasunimin e saj. Në mbledhjet e datave 1.5.1917; 25.6.1917; 26.6.1917; kuvendohet mbi çështje administrative dhe të pāsunimi të saj. Për me majtë rregullin e bibliotekës caktohet drejtues Hil Mosi. Librat e grumbulluem në zbatim të urdhnit Nr. 1106, të Kryekomandës, duheshin me u inventarizu. Biblioteka kishte me mbajtë evidencë dhe administrue simbas mënyrës së caktueme prej Komissisë. Kujdes i veçantë ju kushtu edhe shtimit të fondeve të bibliotekës tuj ble libra të rinj, që flasin për Shqipni, "...prej librëtores ... Ēienē"

Dy momente të tjera të rëndësishme në veprimtarinë e bibliotekës së Komissisë janë: të caktuemit me vendim, për herë të parë në Shqipni i kopjes së detyrueshme për bibliotekat, si dhe puna për vlerësimin e mbikqyrjen e botimeve të reja.

Në mendimin personal vendimet kanë lidhje me mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe me cilësinë e botimeve. Në procesin e mbledhjes datë 1.5.1917, me pjesëmarrjen z. L. Gurakuqi, S. Peci, M. Logoreci, H. Mima, H. Mosi, Nd. Paluca dhe K. Naraçi, për organizimin e bibliotekës lexohet: "Vendohet edhe me ju lutun Kryekomandës të çpallë një urdhen qe seicili auktor a editor të jetë i detyruem me i dhanë bibliotekës nga dy eksemplarë gratis të çfare do botimit", ndërsa në mbledhjen e datës 7. 12. 1917, bibliotekës i caktohet edhe zhvillimi i literaturës shqipe, "tue botuem

vepra shkrimtarësh dhe vjershtarësh shqiptarë që së janë shtypë ende".

Komisia Letrare Shqipe u shpërnda më 1918, dhe librat e bibliotekës u tjetërsuan. Nji grup studiuesish shkodranë, tuj na paraqitë për herë të parë në vjetin 1961, nji histori të plotë të bibliotekave të Shkodrës, sa i takon trajtesës së masipërme shkruiejshin: "Ish pjestarët e nënpunësit e Komissisë Letrare Shqipe, bibliotekën e saj ja kaluen një shoqnie së re kulturore, të krijueme në vj. 1919 nën emnin "Vëllaznija", nën drejtimin e Hilë Mosit. Përgjegjës bibliotekë ishte Kolë Kamsi.

Përfundoj me mendimin tuj ritheksu faktin të dijtun se jo vetëm biblioteka e Komissisë, por edhe biblioteka e shoqnisë "Vëllaznija" e pasunueme tashma ishin pararendëset e Bibliotekës Kombëtare të krijume tashma më 1920.

Epilogu.

Shprehja disa mendime personale, që më lindën si refleksion pozitiv i festimeve të 90 dhe 95, vjetorit të këtij institucioni të pakrahasueshëm kulturor të vendit tonë.

Personalisht vlerësoj shumë punën e bāme nga drejtuesi i kēsaj bibliotekë, Prof. dr. Aurel Plasari, ndihmēsja i tij e zonja Etleva Domi, drejtoresha e sotme, Prof. dr. Persida Asllani, si dhe nga çdo pjesëtar tjetër i stafit të kēsaj bibliotekë që në vite mbetën përherë për ne, punonjësit e bibliotekave në qarqe, shëmbulli që duhet me u ndjekë në sfidat që bibliotekat kanë në kohët e sotme.

Gjovalin ÇUNI,
Drejtori i Bibliotekës "Marin Barleti",
Shkodër

BESA - BESNIKU I SKENËS SË HUMORIT

Besnik Çinari, talenti i lindur, aktori i papërsëritshëm, përfaqësuesi i humorit tipik shkodran, një tjetër pasardhës i shquar i skenës së estradës, por dhe përçuesi i këtij humori nëpërmjet interpretimit dhe krijimtarisë së tij letrar-humoristike.

Të portretizosh një artist, aktor, këngëtar, shkrimtar, piktor a ndonjë sferë tjetër të artit, në përmasat e një shkrimi të tillë, nuk është e lehtë, pasi duhet të hulumtosh për jetën dhe veprimtarinë e tij. Unë si autor, për fatin tim të mirë, nuk e kam këtë vështirësi, pasi këto personazhe i njoh nga afër dhe shpesh, thjesht në bisedat e lira me ta, arrij, jo vetëm të mbledh ato që më duhen, por edhe në ndonjë rast pse jo, të kem edhe oponencën e tyre.

Megjithatë, shpesh i ndjej vështirësitë dhe përgjegjësitë, sepse personazhet nuk janë aspak të zakonshëm, por në veprimtaritë e tyre janë figura që kanë lënë dhe vazhdojnë të lënë gjurmë.

I tillë, shumë i afërt por dhe i largët, një figurë komplekse, është edhe aktori i Estradës Profesioniste të qytetit të Shkodrës, humoristi i mirënjohur Besnik Çinari, për të cilin mora përsipër të bëj këtë shkrim, tanimë i lauruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë z.Bujar Nishani me titullin e lartë "Mjeshtër i Madh".

A do të kishte kuptim ky dekorim pa praninë e Besnik Çinarit, tha presidenti i Republikës z.Bujar Nishani.

I emocionuar, por dhe i plotësuar shpirtërisht, Besnik Çinari përgjigjet: "Nuk është hera e parë që vij në Presidencë dhe më ka bërë shumë përshtypje disiplina dhe devotshmëria në punë e gjithë stafit dhe në qoftë se do të ishin të gjitha institucionet kështu, Shqipëria duhet të ishte shumë më përpara".

Si për gjithë kolegët e tij, artistët e mëdhenj që ka nxjerrë skena shkodrane dhe që janë pjellë e tabanit kulturor të këtij qyteti, ashtu edhe për Besnik Çinarin, sfondi që e shoqëron është Shkodra e tij me historinë, pejsazhin e mrekullueshëm, rrugët plot diell dhe humorin e njerëzve që nuk shterron kurrë.

Me hapjen e Pallatit të kulturës "Vasil Shanto", nën drejtimin e regjisorit të trupave amatore, Verdi Take, ëndrrat dhe dëshirat e Besës gjetën hapsirë për t'u bërë realitet në skenë.

Gjatë aktivizimit në këtë pallat, me ndërhyrjen e aktorit të madh Gëzim Kruja, filloi punë në Fabrikën e Cigareve dhe po me ndihmën e tij përfundoi aktor në

Estradën e Teatrit "Migjeni".

Është viti 1982 me 10 maj, kur filloi punën si aktor profesionist, para 35 vitesh. Ishte shumë vështirë të çaje në atë kohë, pasi aty ai gjeti, jo vetëm kapot e humorit të Shkodrës, por të të gjithë Shqipërisë, si Tano Banushi, Hasan Smaja, Bik Pepa, Gjosh Vasija, Paulin Preka, Zef Deda, Zyliha Miloti, Landi Shala, Drande Xhaj, Katrina Biga, Gëzim Kruja, Sandër Ruçi etj".

Besnik Çinari kishte dhunti që të shkruaj vetë, duke mbijetuar që në vitet e para. Pas disa vitesh avash-avash u poq si aktor me ndihmën e regjisorëve që ka pasur



si Paulin Sekuj, regjisorin e parë, shumë vite, Edmond Mhillin, Gjergj Vlashin e Durrësit, por edhe Tonin Ujkën, Zehrudin Doklen, Arben Haverin, Bardh Smajën, Bruno Shllakun e shumë të tjerë, që kanë vënë shfaqje në skenë.

Me kalimin e viteve padyshim, si çdo aktor, pas disa kohësh Besa rritet profesionalisht dhe skena fillon e bëhet e tia.

Një ditë prej ditësh e ndjeu veten të pjekur, të përgatitur profesionalisht për të përballuar sfidat që sjellin prezantimet para publikut, qofshin dhjetra e qindra vetë, apo mijëra vetë. Artisti një ditë e ndjen stadin ku ka arritur, por megjithatë shpirtërisht ndjen se deri sa të jetë në këtë jetë do të kontribuojë, sepse në gjuhën popullore e ka "mikrob".

Nuk mund ta harrojë kurrë, kur për herë të parë, u prezantua në skenë, në skecin "Pezhishkat" në rolin e fshatarit përkrah Tano Banushit dhe Zyliha Milotit.

Si aktor profesionist, Besa kontribuoi për trupat amatore të ndërmarrjeve dhe institucioneve dhe ky kontribut e plotësoj biografinë artistike, sepse "e hante maraku" që edhe t'i shkruante pjesët vetë. Ama, ajo që i mbetet ndër mend është vënia në skenë e komedisë "Binjakët" e shkruar nga Qazim Çela, ku rolin kryesor e kanë luajtur humoristët e grupit "Thumbi" Muhamet Çekini dhe Bujar Ademovi si dhe aktorët Muharrem Hoxha, i ndjeri Bardh Smaja, Marie Qyrzaqi, Drande Xhaj dhe një aktore tjetër shumë e mirë Rudina Smajlaj.

Me grupin "Thumbi" ka organizuar shumë shfaqje ku sukses të plotë ka arritur në qytetin e Ulqinit çdo të premte, duke parodizuar formatin "Kutia e fundit" të TV Klan, të drejtuar nga Enkel Demi, e titullar "Fundi daltë hajr" dhe "E pakta past' bereqetin" ku janë aktivizuar shumë aktorë e këngëtarë si Bashkim Alibali, Myfarete Laze, Mukades Çanga etj. duke qenë regjisor i këtyre shfaqjeve, të cilat u kthyen në festë për publikun ulqinak.

Pas viteve '90, pas një eksperience dhe përvoja të grumbulluar, natyrisht hyri me vështirësi në hapsirat e reja që u krijuan, por dhe me guxim, duke sjellur në skenë edhe pendën e tij. Aktori, tashmë "Mjeshtër i Madh" Besnik Çinari ka shkruar shumë për sofrat shkodrane, si "Sa bukur na ka dalë nana", komedi të ndryshme, është bashkëautor i komedisë "Bik Brodher Shkodra 1", ka shkruar komplet "Bik Brother Shkodra 2, "Alo telebingo" dhe së fundi është bashkpunëtor me një komedi të Fadil Krajës, të cilën me lejen e autorit e ka rishkruar për skenë.

Ka shkruar shumë parodi, kuplete, skeçe, grimca humoristike, tekste këngësh. Ku mund të veçojmë shkrimet në vargje në një sërë veprash për figurat

e shquara sidomos të qytetit të Shkodrës, por edhe për humoristët e Estradës Profesioniste të Durrësit kolegëve si Fadil Hasa, Muharrem Hoxha, etj.

Si një shkodran i vërtetë, ai thotë se nuk mund të quhem Besë Çinari në qoftë se nuk do të shkruaja edhe për atë që e dua fort, "Vllazninë", sepse kur u themelua Shoqëria "Vllaznia", ishte kulturore, artistike e sportive. Kështu që ka shkruar edhe për futbollistët që "ta kanë fshehur topin nëpër fushë" deri në portë si: Ramazan Rragami, Sabah Bizi, Din Zhega, Paulin Ndoja e shumë figura të tjera të Shkodrës, të cilëve iu ka përshkruar karrierën e tyre në vargje.

Skeçi "Dan Dupi", në të vërtetë do të ishte më saktë të quhej një mikrokomedi, pasi elementët e tij artistik, në përmbajtje dhe shtrirje në kohë, i plotëson këto kushte, prandaj ai erdhi në skenë gati-gati si një komedi e vogël. "Dan Dupi" ka qenë skeç shumë i suksesshëm dhe këtë sukses e arriti, sepse ishte shumë aktual.

"Mjeshtri i Madh" i humorit Besnik Çinari, në rininë e tij, kur kryente shërbimin e detyrueshëm ushtarak në Durrës, ka luajtur edhe me aktorët e mirënjohur të humorit durrsak e shqiptar, Muharrem Hoxha, Aishe Stari e Fadil Hasa, por ka shoqëri të ngushtë edhe me parodistët e Vlorës, të cilët janë të mrekullueshëm, me humoristët e Tiranës të ndjerin Vasil- laq Vangjeli, Vegim Xhani, Veli Rada, aktorët e Estradës Profesioniste të qytetit të Korçës të ndjerin Aleko Prodani, Arben Dervishi e shumë të tjerë, për të vazhduar me Ceken si dhe ata të Estradës Profesioniste të qytetit të Fierit, Luftar Paja, Todi Llupi, Arqileja etj. të cilët i ka jo vetëm kolegë, por edhe shokë.

Besnik Çinari është tepër njerëzor, është një bashkëshort i shkëlqyer dhe prind i mrekullueshëm. Një aktor me nur, një pendë e goditur, me një komunikim brilant me publikun, falë edhe bashkëpunimit të tij me kolegët.

Të flasësh për aktorin e madh Besnik Çinari nuk din nga t'ja fillosh, pasi ai është një humorist i përmasave të mëdha por dhe një krijues, i cili ka një pendë të mprehtë. Ai shkruan vazhdimisht materiale humori shumë të bukur, por me humorin e tij profesional dhe origjinal ka bërë për vete shumë zemra artëdashëse shkodrane si dhe në të gjithë Shqipërinë. Një Besë i mrekullueshëm, besnik i skenës.

Dhe erdhi një ditë që ky artist, kjo figurë e papërsëritshme e skenës shqiptare të vlerësohet për të gjitha ato vlera që ka me titullin e lartë "Mjeshtër i Madh".

Përgatite Ramazan Çeka

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

**Mundësoi
Botimin:
NDUE FTONI**

